Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administration*

HELVETAS
KOSOVO

DALËSE - IZLAZNI - OUTGOING
REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVO
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. Br. No. 454-142/18
-IV-
Data. Datum. Date. 18.03.2023

Prishtinë, 02.03.2023
Nr106/2023

Në mbështetje të nenit 8, 9, 10, 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, nenit 8 paragrafi 1.4, të Rregullores (QRK) - Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenin 5 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Ligjin Nr. 08/l-103 për Sistemin e Menaxhimit të Performancës së Komunave dhe skemën e grantit të bazuar në performancë, si dhe Ligjin Nr. 08/L-193 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, Marrëveshjen e kritereve për financimin e projekteve midis MAPL dhe DEMOS të datës 28.02.2023, si dhe duke u bazuar në Raportin vlerësues për Grantin e Performancës Komunale për vitin 2021 periudha e alokimit 2023 të aprovuar nga Komisioni i Grantit për Performancë Komunale me dt. 17.10.2022, arrihet kjo:

# MARRËVESHJE PËR MBËSHTETJE FINANCIARE TË PROJEKTIT "ASFALTIMI I RRUGËS TRANZIT - LAGJJA E KONJUHIT DERI TE RRUGA REGJIONALE LIPJAN-JANJEVË, FAZA II" NGA SKEMA E GRANTIT PËR PERFORMANCË KOMUNALE

**Ndërmjet:**

1. Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, përfaqësuar nga Ministri i MAPL-së (në tekstin e mëtejmë MAPL),

2. Helvetas Swiss Intercooperation, përfaqësuar nga Menaxheri i Projektit DEMOS (në tekstin e mëtejmë DEMOS) dhe,

3. Komunës së Lipjanit, përfaqësuar nga Kryetari i Komunës (në tekstin e mëtejmë Komuna).

## Neni 1
## Qëllimi

1. Palët nënshkruese të kësaj marrëveshje kanë për qëllim financimin e projektit duke u kujdesur për zbatimin e kritereve, parimeve, procedurave dhe rregullave ligjore të bashkëfinancimit dhe shpenzimit të mjeteve materiale konform dispozitave të kësaj marrëveshje.

2. Marrëveshja parasheh të drejtat dhe detyrimet e palëve në respektimin e rregullave të përcaktuara për bashkëfinancim të projektit, afatet dhe kushtet e tjera kontraktuale për subjektet juridike, me qëllim të shfrytëzimit të drejtë të grantit të performancës komunale dhe rritjes së efikasitetit të komunave në qeverisjen demokratike, menaxhimin komunal dhe ofrimin e shërbimeve cilësore për qytetarë.

**Neni 2**
**Objekti i Marrëveshjes**

1. Kjo marrëveshje ka për objekt bashkëfinancimin e projektit si vijon:
   - **Asfaltimi i rrugës tranzit - lagjja e Konjuhit deri te Rruga regjionale Lipjan- Janjevë, Faza II**

**Neni 3**
**Vlera e projektit dhe mënyra e bashkëfinancimit**

1. Shuma totale e projektit në vlerën e parallogaritur është **€ 323,786.22**

2. Shuma totale e ndarë nga buxheti i MAPL-së për këtë projekt është **€ 0.00**

3. Shuma totale e ndarë nga buxheti i DEMOS për këtë projekt është **€ 313,773.20**

4. Komuna nga buxheti i saj financon këtë projekt në shumën prej **€ 10,013.02**

4. Çfarëdo vlere tjetër që tejkalon shumën e paracaktuar të projektit, financohet nga buxheti i komunës.

**Neni 4**
**Të drejtat dhe detyrimet e MAPL-së**

1. MAPL në zbatim të marrëveshjes për kriteret e financimit të projekteve të Grantit të Përformancës Komunale ( GPK) të datës 28 shkurt 2023 zotohet që:

   a) Të sigurojë zotimin e mjeteve financiare sipas nenit 3.2 e kësaj marrëveshjeje. Një kopje e zotimit të mjeteve i dërgohet komunës. Të kryej obligimet financiare në bazë të realizimit të punimeve/furnizimeve sipas kushteve të kontratës.

   b) Të monitoroj projektin në vazhdimësi dhe bashkëpunon me komunën për implementimin e kushteve të kontratës.

2. MAPL përmes monitoruesit është në kontakt të vazhdueshëm me komunën për këtë projekt dhe në rast se vëren parregullsi apo defekte gjatë realizimit të kontratës/projektit njofton Sekretarin e Përgjithshëm të MAPL-së, i cili ndërmerr hapat në pajtim me legjislacionin në fuqi.

3. MAPL rezervon të drejtën të ndërpresë këtë Marrëveshje dhe të ndërmarrë hapa të mëtutjeshëm sipas legjislacionit në fuqi, në rast se vërtetohet nga raporti i Auditorit të Përgjithshëm, i cili është kërkuar për Grantin e Performancës Komunale për vitin 2021, se komuna ka raportuar të dhëna të pasakta apo fiktive të cilat kanë ndikuar në përfitimin e Grantit të Performancës. Në këtë rast të gjitha përgjegjësitë për këtë projekt i takojnë komunës respektive.

4. MAPL nuk mban përgjegjësi në rast të dështimit të projektit për shkaqe të cilat nuk ndërlidhen me autorizimet e saj, si dhe në rast të ndryshimeve të mundshme të çfarëdo natyre ose shkeljeve që mund të ndodhin gjatë zbatimit të projektit që është në përgjegjësi të komunës.

**Neni 5**
**Të drejtat dhe detyrimet e DEMOS**

1. DEMOS në zbatim të marrëveshjes për kriteret e financimit të projekteve të GPK-së të datës zotohet të siguroj transferin në buxhetin e komunës të shumës financiare të paraparë për projektin sipas nenit 3.3 të kësaj marrëveshjeje.

2. DEMOS, në rast se është financues i projektit, mund të kërkoj informata nga komuna rreth projektit nëse e konsideron të nevojshme. Po ashtu mund të kërkohen informata nga MAPL lidhur me monitorimin e projektit.

3. DEMOS nuk mban përgjegjësi në rast të dështimit të projektit për shkaqe të cilat nuk ndërlidhen me autorizimet e saj, si dhe në rast të ndryshimeve të mundshme të çfarëdo natyre ose shkeljeve që mund të ndodhin gjatë zbatimit të projekteve që është në përgjegjësi të komunës.

**Neni 6**
**Të drejtat dhe detyrimet e komunës**

1. Komuna obligohet të jap kontributin e saj financiar për zbatimin e projektit në shumën e përcaktuar në nenin 3.4 të kësaj marrëveshjeje.

2. Në rast kur financimi i projektit bëhet nga MAPL, komuna pas nënshkrimit të kësaj marrëveshje, obligohet të dërgoj në MAPL informatat e nevojshme për hartimin e PiP (Projekti i Investimeve Publike) me qëllim të zotimit të mjeteve të dala nga kjo marrëveshje, sipas Nr. 08/L-193 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023.

3. Nëse pas procedurave të prokurimit, shuma e projektit rezulton më e ulët se vlera e paracaktuar në nenin 3.1 të marrëveshjes, komuna është e detyruar të zvogëlojë kontributin e saj, ndërsa shuma e GPK-së mbetet e njëjtë deri në përmbushjen e vlerës së projektit, ndërsa pjesa e mbetur nga shuma e GPK-së kthehet.

4. Komuna obligohet të zhvillojë projektin në përputhje me këtë marrëveshje dhe kornizën ligjore në fuqi.

5. Në rast kur financimi i projektit bëhet nga MAPL, komuna obligohet që pas nënshkrimit të kontratës me Operatorin Ekonomik (OE), të sjellë në MAPL një kopje të kontratës dhe ofertën financiare identike me origjinalin, së bashku me informatat për biznesin me qëllim të nxjerrjes së urdhër blerjes, si vijon:

- çertifikatën për regjistrimin e biznesit;
- çertifikatën e numrit fiskal;
- kopjen e kartelës bankare të OE ose vërtetimi nga banka;
- kopjen e dokumentit identifikues të pronarit të biznesit.

6. Në rast kur financimi i projektit bëhet nga DEMOS, komuna obligohet që të informojë MAPL-në dhe DEMOS-in për vlerën finale të projektit pas përfundimit të procedurave të prokurimit dhe të dërgoj një kopje të kontratës, ofertën financare dhe raportit të vlerësimit të tenderit.

7. Komuna cakton projekt menaxherin/organin mbikëqyrës për mbikëqyrjen e kryerjes së punimeve dhe komisionin i cili lëshon certifikatën e pranimit të punimeve/pranimin teknik.

8. Projekt menaxheri/organi mbikëqyrës me përgjegjësi të plotë, vërteton sasitë dhe kualitetin e punëve/furnizimeve të kryera, në bazë të cilave operatori ekonomik lëshon dokumentin financiar (faturën), me kërkesën për realizimin e pagesës të punimeve/furnizimeve të kryera, duke iu referuar kushteve të kontratës.

9. Komuna është e detyruar t'ia sigurojë MAPL-së dhe DEMOS-it kopjet e të gjitha dokumenteve për përmbylljen e projektit, përfshirë:

- kopjen e pranimit teknik/pagesat si konfirmim zyrtar për përfundimin e projekteve dhe
- shumën finale të projektit.

10. Komuna obligohet që të njoftojë MAPL-në për çdo propozim ndryshim eventual të sasisë dhe kualitetit gjatë implementimit të projektit

11. Komuna obligohet të informojë MAPL-në për dinamikën e punimeve deri në përfundim të projektit.

12. Komuna obligohet që para inaugurimit të projektit të njoftojë MAPL-n dhe DEMOS dhe të dërgojë ftesë për pjesëmarrje.

13. Komuna obligohet që para fillimit të realizimit të punimeve në terren të vendosë tabelën informuese (panon) në vend ndërtim, me të gjitha informatat e nevojshme lidhur me projektin duke përshirë edhe tekstin "Emrin e Projektit, vlerë dhe burimin e financimit, në kuadër të skemës së grantit të përformancës".

14. Komuna obligohet që gjatë çdo aktiviteti apo postim promovues lidhur me projektin, të përfshijë "Emrin e Projektit, vlerë dhe burimin e financimit, në kuadër të skemës së grantit të përformancës".;

15. Komuna obligohet që pas përfundimit të punimeve në terren, të organizoj ceremoninë përmbyllëse të projekti. Ftesa për pjesëmarrje në ketë ceremoni duhet të dërgohet në MAPL dhe tek Donatoret së paku 10 ditë para mbajtjes së ceremonisë.

16. Në rast të mos respektimit të rregullave dhe standardeve të cekura në pikat 12, 13, 14 dhe 15 të këtij neni nga Komuna, mund të aplikohet neni 10.2 i kësaj marrëveshje.

17. Projektet janë të qasshme në çdo kohë për auditim të rregullt vjetor që kryhet nga Zyra Kombëtare e Auditimit në Kosovë (ZKAK) dhe për auditimet e kërkuara nga DEMOS-i dhe/ose donatorët e tij për projektet e financuara nga buxheti i DEMOS si pjesë e GPK-së.

**Neni 7**
**Dokumentacioni i nevojshëm i komunës për pagesë të projektit të financuar nga buxheti i MAPL**

1. Komuna obligohet që për të realizuar pagesat për punët/furnizimet e kryera të kompletojë dokumentacionin si në vijim:

1.1. Kopjen e Kontratës të nënshkruar së bashku me Kushtet e përgjithshme, të veçanta dhe ofertën financiare e cila duhet të jetë identike me origjinalin e vërtetuar nga menaxheri i prokurimit të komunës.

1.2. Vendimin për caktimin e projekt menaxherit/organit mbikëqyrës/komisionin e pranimit nga ana e Komunës, në rast se nuk është e definuar me kushtet e veçanta në kontratë.

1.3. Raportin e projekt menaxherit/organit mbikëqyrës, komisionit të pranimit mbi punët/furnizimet e kryera të aprovuara (origjinali).

1.4. Faturën nga operatori ekonomik dhe situacionin e aprovuar (origjinali).

1.5. Sigurimin e ekzekutimit, garancionin e kualitetit me pranim teknik sipas kushteve të kontratës.

**Neni 8**
**Afati i realizimit të projektit**

1. Komuna duhet të ndërmerr të gjitha masat që projekti i financuar nga MAPL të përfundojë brenda vitit fiskal 2023.

2. Komuna duhet të ndërmerr të gjitha masat që projekti i financuar nga DEMOS të filloj në vitin 2023 dhe të përfundojë brenda vitit fiskal 2023. Në rast se projekti nuk përfundon gjatë vitit 2023, komuna mund t'i bart mjetet e pashpenzuara të GPK-së në vitin 2024 për vazhdimin e projektit sipas kësaj marrëveshje. Fondet e pashpenzuara sipas nenit 3.3 duhet t'i kthehen DEMOS jo më vonë se 25 dhjetor 2024.

3. Pas përfundimit të afatit të përcaktuar në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni, të gjitha detyrimet i bartë Komuna.

**Neni 9**
**Pronësia e projektit**

1. Pas përfundimit të projektit dhe pranimit teknik, projekti i financuar sipas kësaj marrëveshje do të transferohet në pronësi të Komunës.

2. Komuna është e detyruar të regjistrojë projektin nën pronësi të saj brenda sistemit të aseteve të Ministrisë së Financave dhe Transfereve (SIMFK).

3. Projekti kalon në pronësi të komunës vetëm pasi që pasuria jo financiare i ka kaluar të gjitha rregullat dhe procedurat e dorëzimit, pagesën e fundit me pranim teknik, kur MAPL i kryen të gjitha pagesat e situacioneve dhe në rastet e bashkëfinancimit kur komuna e kryen pagesën - situacionin e fundit me pranim teknik. Me këtë rast, MAPL mbyll llogarinë e investimeve, ndërsa Komuna, pasurinë jo financiare të pranuar nga MAPL e regjistron në regjistrat e pasurisë jo financiare të saj.

**Neni 10**
**Ndryshimet dhe ndërprerja e Marrëveshjes së Bashkëfinancimit**

1. Marrëveshja mund të ndryshohet dhe plotësohet sipas pëlqimit paraprak të MAPL-së, DEMOS-it dhe Komunës.

2. MAPL dhe DEMOS mbajnë të drejtën e ndërprerjes së Marrëveshjes në rast se Komuna nuk i përmbahet kushteve të kësaj marrëveshje.

**Neni 11**
**Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

1. Palët do të përpiqen të zgjidhin në mënyrën më të përshtatshme, çdo mosmarrëveshje që buron nga kjo Marrëveshje bashkëpunimi.

2. Nëse nuk do mundet të zgjidhen mosmarrëveshjet me mirëkuptim sipas paragrafit 1 të këtij neni, palët dakordësojnë se kompetencën për të shqyrtuar është gjykata kompetente.

**Neni 12**
**Hyrja në fuqi**

1. Kjo marrëveshje hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit të saj nga MAPL, DEMOS dhe Komuna.

2. Kjo marrëveshje është nënshkruar në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze në tri (3) kopje autentike, një për secilën nga palët nënshkruese.

| | | |
|---|---|---|
| **Elbert Krasniqi** | **Ertan Munoglu** | **Imri Ahmeti** |
| Ministër i MAPL-së | Menaxher i projektit DEMOS | Kryetar, Komuna e Lipjanit |

Bethany CHRISTIAN SERVICES

REPUBLIKA E KOSOVES
KOMUNA LIPJAN
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN

| Pranuar më: Primljeno: | 06.02.2023 | |
|---|---|---|
| Njësia Jednica | Numri Broj | Shtojca Dodatak |
| 1-660/03-6474 | | |

**MEMORANDUM BASHKËPUNIMI**

*në mes të*

**KOMUNËS SË LIPJANIT**

dhe

**BETHANY CHRISTIAN SERVICES**

**"Funksionimi i Qendrave me Bazë në Komunitet për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme"**

**Kjo MARRËVESHJE E BASHKËPUNIMIT** është lidhur në mes të Komunës së Lipjanit, Rr. Shqipëria, nr. 28, Lipjan, si entitet ligjor i plotëfuqishëm në qeverisjen lokale, në harmoni me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale, përfaqësuar nga **Kryetari, z. Imri Ahmeti.**

dhe

**Bethany Christian Services (BCS)**, me adresë Rr.„Martirët e Kombit", Brekoc, Gjakovë, organizatë jo-qeveritare përfaqësuar nga **Drejtori Ekzekutiv, z. Berat Thaqi.**

**NDËRSA** Komuna e Lipjanit si autoritet lokal përmes mekanizmave të tij institucional kujdeset që të gjithë banorët e komunës pa dallim race, kombësie, ngjyre, gjinie, gjuhe, feje, opinioni politik apo tjetër, origjine kombëtare apo sociale, pavarësisht pronës apo ndonjë statusi tjetër, do t'i gëzojnë të gjitha të drejtat dhe liritë;

**NDËRSA**, BCS punon me qeveri, komuna, organizata të shoqërisë civile dhe partnerë tjerë për t'i çuar përpara të drejtat e fëmijëve për mbijetesë, mbrojtje, zhvillim dhe pjesëmarrje, udhëzuar nga Konventa e të Drejtave të Fëmijëve;

**NDËRSA**, Komuna e Lipjanit dhe BCS-i janë të gatshëm të pranojnë një partneritet bazuar në diskutime dhe marrëveshje të përbashkëta për ta zbatuar "Funksionimi i Qendrave me Bazë në Komunitet për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme";

**NDËRSA,** "Funksionimi i Qendrave me Bazë në Komunitet për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme" synon të mbështesë një komunë që është e përkushtuar për t'i përmbushur të drejtat e fëmijëve për zhvillim dhe edukim të hershëm dhe është një thirrje për veprim dhe përkushtim për t'i përfshirë implikimet buxhetore të ofrimit të edukimit të hershëm përmes Qendrave me Bazë në Komunitet në buxhetin komunal.

**NDËRSA,** "Funksionimi i Qendrave me Bazë në Komunitet për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme" është një thirrje për gjithëpërfshirje dhe llogaridhënie për Fëmijët;

**NDËRSA,** "Funksionimi i Qendrave me Bazë në Komunitet për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme" promovon vizionin që fëmijët në Komunën e Lipjanit do të jenë të lumtur përderisa luajnë, edukohen dhe rriten në një ambient të sigurt, të qëndrueshëm e gjithëpërfshirës. Në praktikë, kjo nënkupton që të drejtat e fëmijëve pasqyrohen në mënyrë të përshtatshme në politikat, rregulloret, programet dhe buxhetet komunale;

**PRANDAJ,** Komuna e Lipjanit dhe BCS-i janë duke lidhur këtë MM për të përmirësuar më tutje jetën e fëmijëve dhe të familjeve të tyre përmes Qendrave me Bazë në Komunitet për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme në fashtrat Magure dhe Shalë të Komunës së Lipjanit.

Bashkëpunimi dhe mbështetja e ofruar nga Bethany Christian Services në kuadër të këtij Memorandumi realizohet në kuadët të projektit të mbështetur nga UNICEF në Kosovë, me fokus në rritjen e disponueshmërisë dhe qasjes në edukimin e hershëm posaçërisht për fëmijët e margjinalizuar dhe në zona rurale.

### Fushëveprimi i këtij Memorandumi te Bashkepunimit

Udhëhequr nga Konventa e të Drejtave të Fëmijëve, Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, dhe parimi Të Mos Lihet Askush Pas, legjislacioni i zbatueshëm dhe kontributi në procesin e Hyrjes në BE, Komuna e Lipjanit dhe BCS pajtohen të bashkëpunojnë, të zgjerojnë dhe të mbajnë marrëdhënie të afërta dhe të vazhdueshme të bashkëpunimit, duke përfshirë:

- Angazhimin e edukatoreve (2) në Qendrat me Bazë në Komunitet në Magure dhe Shalë,
- Monitorimin e punës dhe performancës së edukatoreve,
- Monitorimin e vijueshmërisë së fëmijëve, ndryshimin në kërkesën për shërbime në vendbanimet/komunitetet përkatëse,
- Ofrimin e materialeve të nevojshme për realizimin e aktiviteteve te lojës edukative,
- Ofrimin e mbështetjes së vazhdueshme për zhvillimin e kapaciteteve profesionale të edukatoreve të angazhuara në Qendrat me Bazë në Komunitet,
- Ofrimin e mbështetjes për ngritjen e kapaciteteve të prindërve/kujdestarëve ligjor, angazhimin e tyre aktiv në zhvillimin dhe edukimin e fëmijëve dhe bashkëpunimin në nivel të komunitetit të gjerë
- Sigurimin e qëndrueshmërisë së operimit të Qendrave me Bazë në Komunitet, në formën e tyre ekzistuese ose formë tjetër të organizimit përmes integrimit në buxhet komunal

siç është e përshtatshme për të arritur rezultate dhe për t'i realizuar aktivitetet e propozuara të programit të edukimit të hershëm.

## Përgjegjësitë e Palëve

**Komuna e Lipjanit, Drejtoria Komunale për Arsim merr përsiper:**

- Të bashkëpunoj me BCS për realizimin e te gjitha aktiviteteve, detyrave dhe përgjegjësive të parashikuara në këtë Memorandum
- Të angazhohet të siguroj vazhdimësinë e veprimtarisë së edukatoreve në Qendrat me Bazë në Komunitet në Magur dhe Shalë pas përfundimit të mbështetjes nga BCS, përmes projektit të finacuar nga UNICEF më Kosovë, duke planifkuar ne buxhetin komunal financimin e edukatoreve në këto Qendra dhe financimin e kostos operative për realizimin e aktiviteteve edukative.
- Të bëjë vlerësimin dhe monitorimin e performancës së edukatoreve

**Bethany Christian Service merr përsiper:**

- Të mbulojë shpenzimet financiare për angazhimin e dy (2) edukatoreve në Qendrat me Bazë në Komunitet për fëmijët 3 dhe 4 vjec, në fshatrat Magure dhe Shalë të Lipjanit, për periudhën Janar-Qershor 2023, në shumën mujore prej 300.00 Eur neto për një edukatore.
- Të mbështesë edukatoret me udhëzime dhe materiale, si dhe shkëmbim përvojash në realizimin e programit edukativ për edukim të hershëm
- Të sigurojë pajisjen me materiale didaktike për realizimin e aktiviteteve të lojës edukative
- Të mbështesë vlerësimin dhe monitorimin e performancës së edukatoreve.

**Modalitetet e Bashkëpunimit brenda Programit dhe Këmbimit të Informatave**

1. Komuna e Lipjanit dhe BCS pajtohen të shkëmbejnë informata dhe dokumente rregullisht mes njëri tjetrit dhe me të gjithë akterët e përfshirë, në masën më të plotë për të gjitha çështjet e interesit të përbashkët;

2. Palët pajtohen që BCS do të ofrojë ekspertizë teknike nga stafi dhe partnerët e tij si dhe përkrahje financiare për t'i realizuar aktivitetet e përshkruara në **Fushëveprimin e këtij MM,** ndërsa Komuna e Lipjanit do të sigurojë lehtësimin e ndërhyrjeve programatike të BCS si dhe do të sigurojë qasje në të dhëna përkatëse administrative nëse është e nevojshme për qëllimin e zbatimit të "Funksionimi i Qendrave me Bazë në Komunitet për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme".

**Komunikimet lidhur me "Funksionimi i Qendrave me Bazë në Komunitet për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme"**

1. Përpilimi i të gjitha materialeve komunikuese për konceptin e dakorduar të "Funksionimi i Qendrave me Bazë në Komunitet për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme" të koordinohet, shqyrtohet dhe miratohet bashkërisht nga të dy palët para përdorimit të tyre.

**Marrëveshjet financiare**

1. Ky Memorandum nënkupton se BCS do të bart koston financiare të angazhimit të gjithsej 2 edukatoreve për realizimin e programit të edukimit të hershëm për periudhën e cekur të këtij MM, përfshirë të furnizimit me materialet e nevojshme për realizimin e programit edukativ.
2. Komuna e Lipjanit, përmes këtij Memorandumi zotohet se do të angazhohet që të bart koston financiare për realizimin e programit të edukimit të hershëm në Qendrat me Bazë në Komunitet në fshatrat Magure dhe Shalë pas periudhës së aplikueshmërisë së këtij Memorandumi, duke siguruar alokime për kategoritë respektive të shpenzimeve në kuadër të buxhetit komunal.

**Kushtet shtesë të Memorandumit**

1. Të gjitha informatat dhe materialet, duke përfshirë informatat digjitale dhe ato të transmetuara në mënyrë elektronike që ndonjëra Palë planifikon t'i vë në disponim për publikun apo për palë të treta, që përmbajnë emrin dhe logon e BCS apo prona të tjera intelektuale që posedon BCS që mund të përdoren në lidhje me këtë MM apo duke iu referuar atij, duhet të shqyrtohen dhe të miratohen nga të dy Palët para se të përdoren. Asnjëra Palë në këtë MM nuk do ta ndryshojë dukjen apo paraqitjen e emrit, logos apo pronës intelektuale të Palës tjetër.

2. Komuna e Lipjanit e pranon që i njeh parimet dhe objektivat e BCS dhe e pranon që emri dhe logoja e BCS nuk mund të shoqërohen me ndonjë kauzë politike apo sektare apo të përdoren në një mënyrë që nuk është në pajtim me statusin, reputacionin dhe neutralitetin e BCS.

3. Komuna e pranon dhe pajtohet që zbatimi i të gjitha dispozitave të këtij Memorandumi duke përfshirë detyrimet e BCS do t'iu nënshtrohen, pa mundësi heqjeje, privilegjeve dhe imuniteteve të BCS dhe vetëm në një masë që është në përputhje me to.

**Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

1. Në rast të ndonjë mosmarrëveshjeje që mund të lindë nga ky Memorandum apo në lidhje me këtë Memorandum, palët do të mundohen ta zgjidhin me mirëkuptim atë mosmarrëveshje përmes pajtimit. Pajtimi do të realizohet në pajtim me Aktet Ligjore të cilat janë në fuqi.

2. Çdo mosmarrëveshje, polemikë apo akuzë që mund të lindë nga ky Memorandum apo në lidhje me këtë Memorandum apo për shkeljen, ndërprerjen ose pavlefshmërinë e Memorandumit që nuk zgjidhet me mirëkuptim brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditësh pas datës

së akuzës apo nëse BCS nuk merr një ftesë me shkrim për pajtim në përputhje me paragrafin e parë të këtij neni, do të zgjidhet përmes arbitrazhit në përputhje me Aktet Ligjore të cilat janë në fuqi aktualisht. Vendimi i arbitrazhit është përfundimtar dhe detyrues për palët kontraktuese.

**Kohëzgjatja e Memorandumit**

1. MM do të jetë në fuqi nga data 04 Janar 2023 deri më 30 Qershor 2023. Nëse ndonjëra Palë dëshiron të hiqet nga bashkëpunimi, kjo mund të bëhet me shkrim me njoftim së paku 2 (dy) muaj më herët.

2. Para ndërprerjes, të dyja palët do t'i marrin hapat e nevojshëm për t'i finalizuar aktivitetet e tyre përkatëse në kuadër të këtij MM në kohë dhe në mënyrë të organizuar për përfundimin e suksesshëm të të gjitha aktiviteteve në pritje të këtij bashkëpunimi.

3. Ky Memorandum do të hartohet në kopjen në gjuhën shqipe, me një kopje për secilën Palë.

Në emër të Komunës së Lipjanit

____________________________

Kryetar i Komunës së Lipjanit

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E LIPJANIT
REPUBLIKA KOSOVO OPŠTINA LIPLJAN
LIPJAN

Në emër të Bethany Christian Services

____________________________

Drejtor Ekzekutiv i Bethany Christian Services

Bethany Christian Services
BSC
5300262-5
Gjakovë

CARITAS Schweiz Suisse Svizzera Svizra

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA LIPJAN
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN

| Pranuar më: Primljeno: | 06. 02. 2023 | |
|---|---|---|
| Njësia Jednica | Numr. Broj | Shtojca Dodatak |
| 1-660/03-6458 | | |

OJQ ndërkombëtare Caritas Switzerland (në Kosovë), e regjistruar në Ministrinë e Administratës Publike me nr. të certifikatës 5300055-0, me certifikatë të numrit Fiskal 600035944; me adresë Fazli Balaj nr. 59, 10000 Prishtinë, Kosovë, me përfaqësues ligjor Z. Gerhard Schaumberger.

dhe

Komuna e Lipjanit me adresë "Rr. Shqipëria nr. 28"14000 Lipjan, Kosovë, me përfaqësues ligjor Kryetari Imri Ahmeti, dhe Drejtoria Komunale për Arsim, me përfaqësues ligjor Drejtor Rasim Hasani,

lidhin këtë,

# MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

*Projekti: Ndikimi i Rinisë në Mjedis – YENI (P220002)*

International NGO Caritas Switzerland in Kosovo, registered in the Ministry of Public Administration with certificate no. 5300055-0, with Fiscal number certificate 600035944; at the address, Fazli Balaj No. 59, 10000 Prishtina, Kosova, represented legally by Mr. Gerhard Schaumberger.

and

Municipality of Lipjan, at the address "Rr. Shqipëria nr. 28"14000 Lipjan, Kosovo is represented legally by the Mayor Imri Ahmeti and the Municipality Education Directorate is represented legally by the Director Rasim Hasani,

hereby enter into this,

# COOPERATION AGREEMENT

*Project: Youth Environmental Impact – YENI (P220002)*

CARITAS Schweiz Suisse Svizzera Svizra

## Neni 1: Lënda e marrëveshjes

Kjo marrëveshje lidhet nga dhe mes Caritasit Zviceran (CaCH), Komunës së Lipjanit, si dhe Drejtorisë Komunale të Arsimit (DKA) në Lipjan në kuadër të projektit "Ndikimi i Rinisë në Mjedis" (YENI), përkatësisht projekti me nr. P220002.

## Neni 2: Projekt i Caritasit Zviceran

Caritasi Zviceran në bashkëpunim me Ministrinë e Zhvillimit Rajonal (MZHR) është duke zbatuar projektin YENI me qëllimin që të përmirësojë veprimin klimatik dhe mbrojtjen e mjedisit përmes angazhimit të të rinjëve në shkollat e mesme në Kosovë. Duke u bazuar në analizimin dhe vlerësimin e nevojave, Caritasi Zviceran ka zhvilluar projektin Ndikimi i Rinisë në Mjedis (YENI) për fuqizimin e rolit të të rinjëve të shkollave të larta të mesme ndaj ndryshimeve klimatike dhe mbrojtjes së mjedisit duke përfshirë edhe institucionet e tjera relevante.

Objektivi i përgjithshëm i projektit YENI është:
- Përmirësimi i veprimit klimatik dhe mbrojtja e mjedisit në komunat Kosovës përmes angazhimit aktiv të të rinjve.

Ndërsa, rezultatet e pritura përfshijnë:
- Janë themeluar dhe fuqizuar Klubet ekologjike (Eko-klubet) në shkollat e larta të mesme në komunën e Lipjanit;
- Janë ofruar modulet trajnuese për këshillat e nxënësve dhe Eko-klubet, me qëllim të zhvillimit të kapaciteteve të tyre;

## Article 1: Subject of the Agreement

This agreement is entered into by and between Caritas Switzerland (CaCH), Municipality of Lipjan and Municipality Directorate of Education (MED) in Lipjan within the project "Youth Environmental Impact" (YENI) no. P220002.

## Article 2: Project of Caritas Switzerland

Caritas Switzerland together with Ministry of Regional Development (MRD) is implementing the YENI project with the aim of improving climate action and environmental protection through the engagement of young people in higher secondary schools in Kosovo. Based on analysing and assessing the needs, Caritas Switzerland has developed the project's impact on the environment (YENI) to strengthen the role of high school youth in climate change and environmental protection including other relevant institutions.

The overall objective of the YENI project is:
- Improved climate action and environmental protection in Kosovar municipalities through active engagement of youth.

While the expected results include:
- Ecological Clubs (Eco-clubs) have been established and strengthened in higher secondary schools in the municipality of Lipjan;
- Training modules have been provided for student councils and Eco-clubs, to develop their capacities;

| | |
|---|---|
| - Janë aftësuar mësimdhënësit (biologjisë/ekologjisë etj) e shkollave të mesme në fushën e mbrojtjes së mjedisit dhe ndryshimeve klimatike si dhe ngritja e vazhdueshme e kapaciteteve të tyre<br>- Ofrohen mbështetje për përpilimin dhe realizimin e projekteve mjedisore në shkollat e mesme sikurse që është cekur në shkresën e komunës së Lipjanit të datës 26.01.2023 dhe nr. Protokolli 610/01-4766.<br>- Janë hartuar dhe përgatitur materialet mësimore për ndryshime klimatike dhe mbrojtje të mjedisit;<br>- Ofrohet mbështetje për përpilimin e planeve rinore në mbrojtjen e mjedisit dhe përfshirjen e tyre në Planin Lokal për Veprim në Mjedis;<br>- Zyrtarët mjedisor, zyrtarët tjerë relevantë pranojnë dhe bashkëpunojnë plotësisht me Këshillat e nxënësëve dhe Eko-klubet lidhur me komponentën rinore të Planeve Lokal për Veprim në Mjedis si dhe realizimit të fushatave vetëdijësuese.<br>- Këshillat Studentorë dhe Eko-Klubet bëhen pjesë e nismës kombëtare për mbrojtjen e mjedisit dhe ndryshimet klimatike.<br>- Promovohet agjenda mjedisore rinore në nivel të komunës.<br><br>Për të arritur objektivin dhe rezultatet e lartpërmendura, të cilat kontribuojnë në ngritjen e kapaciteteve të mësimëdhënësëve, Këshillave të nxënësëve, Eko-klubeve dhe aktereve tjerë nga Komuna, në vijim do të përfshihen disa nga aktivitetet e krijuara që do të zbatohen bashkërisht nga CaCH dhe partnerët e saj:<br>- Organizimi dhe ofrimi i trajnimit për mësimdhënës të shkollave të larta të mesme në komunën e Lipjanit në fushën e mbrojtjes së mjedisit dhe ndryshimeve klimatike;<br>- Organizimi i sesioneve për trajnim, këshillim dhe mentorim për Eko klubet në shkollat e mesme;<br>- Mobilizimi i pikave përkatëse kontaktuese për projektin YENI në nivel komunal; | - Teachers (biology/ecology, etc.) of high schools have been trained in the field of environmental protection and climate change as well as the continuous increase of their capacities.<br>- Support is provided for the design and implementation of environmental projects in secondary schools as stated in the municipal letter/request of Lipjan dated 26.01.2023 and protocol no. 610/01-4766.<br>- Teaching materials for climate change and environmental protection have been drafted and prepared<br>- Provide support for the compilation of youth plans in environmental protection and their involvement in the local environment action plan;<br>- Environmental officials and other relevant officials fully accept and cooperate with Student Councils and Eco-clubs regarding the youth component of Local Environmental Action Plans as well as conduct awareness campaigns.<br>- Environmental projects have been implemented in high schools.<br>- Student Councils and Eco-Clubs become part of the national initiative for environmental protection and climate change.<br>- Youth environmental agenda is promoted at the municipal level.<br><br>To attain the above-mentioned objective and results, which contribute to the capacity building of teachers, Student Councils, Eco-clubs and other actors from the Municipality, the following will be included some of the activities created that will be implemented jointly by CaCH and its partners:<br>- Organizing and providing training for higher secondary school's teachers in the municipality of Lipjan in the field of environmental protection and climate change.<br>- Organizing training, counselling, and mentoring sessions for Eco clubs in high schools.<br>- Mobilization of relevant contact points for the YENI project at the municipal level. |

CARITAS Schweiz Suisse Svizzera Svizra

- Bashkëpunimi me zyrtarë mjedisor dhe avokimi në nivel komunal për rëndësinë e ndryshimeve klimatike dhe nevojën e përfshirjes së të rinjëve;
- Ofrimi i grantit për projekte të vogla mjedisore për shkollat e mesme të përzgjedhura;
- Monitorimi i implementimit të projekteve mjedisore.

### Neni 3: Përgjegjësitë e Caritasit Zviceran

CaCH do të ofrojë lidership, udhëzime, mbështetje organizative dhe financiare për zbatimin e aktiviteteve që përmirësojnë veprimin klimatik dhe mbrojtjen e mjedisit përmes trajnimeve dhe ngritjes së kapaciteteve për mësimdhënësit, për nxënësit në shkollat e mesme, Eko-klubet, Këshillat e Nxënsëve në komunën e Lipjanit.

CaCH do të sigurojë trajnim cilësor për mësimdhënësit në fushën e mbrojtjes së mjedisit dhe ndryshimeve klimatike përmes Master trajnerëve. Njëkohësisht, CaCH do të sigurojë trajnim, këshillim dhe mentorim cilësor për anëtarët e Eko klubeve, Këshillave të nxënësëve të trajnuar përmes master trajnerëve të tyre.

Për projekt të vogël mjedisor në shkollat e larta të mesme të Komunës së Lipjanit, CaCH do të sigurojë 90%, respektivisht EUR 4,400 (katër mijë e katërqind).

OJQ-ja partnere e zgjedhur nga CACH do të vlerësojë dhe shpërblejë projektet mjedisore në shkallë të vogël.

CaCH obligohet të caktojë një person kontaktues për koordinim të punëve mes komunës, partnereve dhe CaCH si dhe të informojë DKA

- Cooperation with environmental officials and advocacy at the municipal level on the importance of climate change and the need for youth involvement
- Providing a grant for small-scale environmental projects for selected high schools.
- Monitoring the implementation of environmental projects.

### Article 3: Responsibilities of Caritas Switzerland

CaCH will provide leadership, guidance, organizational and financial support for the implementation of activities that improve climate action and environmental protection through training and capacity building for teachers, high school students, Eco-clubs, Student Councils in the municipality of Lipjan.

CaCH will provide quality training for teachers in the field of environmental protection and climate change through Master Trainers. CaCH will provide quality training, counselling, and mentoring for members of Eco Clubs, Student Councils trained through their master trainers.

For a small-scale environmental project in the higher secondary schools of the Municipality of Lipjan, CaCH will provide 90%, respectively EUR 4,400 (four thousand four hundred).

The chosen partner NGO of CACH will evaluate and reward small-scale environmental projects.

CaCH is obliged to name a contact person for coordination of works between the Municipality, partners, and CaCH as well as to inform the

për procesin dhe realizimin e projektit, kurdo që kjo kërkohet nga DKA.
CaCH do të sigurojë të gjitha kapacitetet e nevojshme njerëzore me qëllim që të zhvilloj progresin e projektit.
CaCH do të ofrojë punëtori për ngritje të kapaciteteve në fushën e ndryshimeve klimatike dhe mbrojtjen e mjedisit për zyrtarët mjedisor, të DKA-ve, menaxhmentit të shkollave të mesme etj.

MED of the process and realisation of the project whenever is requested by MED.
CaCH will provide all the necessary human capacity to develop the progress of the project.
CaCH will provide capacity-building workshops in the field of climate change and environmental protection for environmental officials, MEDs, high school management, etc.

### Neni 4: Përgjegjësitë e DKA

DKA do të marr pjesë në mënyrë aktive në zbatimin e aktiviteteve të projektit brenda objektivave dhe rezultateve specifike.

DKA do të sigurojë gjithë mbështetjen e nevojshme administrative dhe logjistike si dhe burimet njerëzore, nëse është e nevojshme, me qëllim që të asistojë në zbatimin e papenguar të aktiviteteve të projektit.

DKA/Menaxhmenti i Shkollës së mesme do të ofrojnë qasje në mjediset e shkollës dhe të ofrojnë mbështetjen e duhur, si dhe të ndërmarrin veprimet e nevojshme për themelimin e Eko-Klubeve në shkollat e tyre.
Menaxhmenti i shkollës do të përcaktojë një person kontaktues në nivel shkolle për këtë projekt, i/e cili/a do të ofrojë të gjithë mbështetjen e duhur për realizimin e aktiviteteve të përcaktuara me projektin YENI.
Njëkohësisht ata do të sigurojnë pjesëmarrje në trajnime dhe takime të përbashkëta (Menaxhmenti i shkollës, Këshilli i Nxënësëve dhe Eko-Klubet).
Komuna/DKA do të ofrojë mbështetjen e saj me qasje dhe ofrim të të dhënave për realizimin e studimeve dhe hulumtimeve të tjera të ndërlidhura me projektin YENI.

### Section 4: Responsibilities of the MED

MED will actively participate in the implementation of the project activities within the respective objective and results.

MED will provide all required administrative and logistics support, and human resources, if required, to assist in the smooth implementation of the project activities.

The MED/High School Management will provide access to the school premises and provide appropriate support, as well as take the necessary actions to establish Eco-Clubs in their schools.

The school management will appoint a contact person at the school level for this project, who will provide all the necessary support for the implementation of the activities defined by the YENI project.

At the same time, they will provide participation in joint trainings and meetings (School Management, Student Council, and Eco-Clubs).

The Municipality/MED will provide its support by accessing and providing data for the implementation of studies and other research related to the YENI project.

DKA do të caktojë një person kontaktues që të asistoj në zbatimin e aktiviteteve në nivel teknik. Ky person do e ndihmojë ekipin e projektit në rishikimin dhe koordinimin e miratimit të planit të veprimit që përvijon të gjitha aktivitetet e ndërlidhura me komunën. Për më tepër, personi kontaktues do të asistojë ekipin e projektit në koordinimin e veprimeve me shkollat dhe mësimdhënësit përkatës në kuadër të komunës, në ofrimin e trajnimit, organizimin e punëtorive me zyrtarët e DKA-ve si dhe në organizimin e trajnimeve si dhe aktivitete tjera sipas nevojës.

Për projekt të vogël mjedisor në shkollat e mesme të Komunës së Lipjanit, Komuna/DKA do të sigurojë 10% respektivisht EUR 440 (katërqind e katërdhjetë). Kjo shumë EUR 440 duhet lëshuar në llogarinë e CaCH para fillimit të aktivitetit në komunën përkatëse.

**Neni 5: Raportimi**

Caritasi Zviceran (CaCH), pas përfundimit të të gjitha procedurave si dhe zbatimit të projektit të referuar në nenin dy (2) të kësaj Marrëveshje, do të përgatisë dhe dorëzojë një raport narrativ përfundimtar me shkrim si dhe raportin financiar për zbatimin e projektit, që do të ndahen me Komunën e Lipjanit.

**Neni 6: Përputhshmëria me ligjin**

Kjo marrëveshje rregullohet sipas ligjeve në fuqi në Republikën e Kosovës.

Kjo marrëveshje nuk do të bie ndesh me asnjë marrëveshje bashkëpunimi të cilësdo palë që është krijuar me palët e treta.

MED will appoint one focal person to assist with the implementation of activities on a technical level. This person will assist the project team in reviewing and coordinating the approval of an action plan delineating all the activities related to the Municipality. In addition, the focal person will assist the project team in coordinating actions with respective schools and teachers within the Municipality in the provision of training, organisation of workshops with MED officials and organisation of training and other activities as required.

For small-scale environmental project in the high schools of the Municipality of Lipjan, Municipality/MED will provide 10% respectively EUR 440 (four hundred and forty). This amount of EUR 440 must be issued to the CaCH account before the start of the activity in the respective municipality.

**Article 5: Reporting**

Caritas Switzerland (CaCH), upon the completion of all procedures and implementation of the project referred to in Article 2 of this Agreement, will prepare and submit a final written narrative and financial report for the implementation of the project which will be shared with the Municipality of Lipjan.

**Article 6: Compliance with the law**

This agreement shall be governed by the laws in force in the Republic of Kosovo.

This agreement shall not conflict with any cooperation agreement of any of the parties herein established with the third parties.

## Neni 7: Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Të gjitha mosmarrëveshjet, kontradiktat apo pretendimet që ngritën apo ndërlidhen me këtë marrëveshje do të zgjidhen në mënyrë miqësore, përmes negociatave mes palëve, brenda 30 ditëve.

Palët dakordohen specifikisht që çfarëdo shkelje materiale e kësaj marrëveshje mund të dërgojë në ndërprerjen e saj të menjëhershme, me kusht që palët fillimisht të përpiqen të zgjidhin mosmarrëveshjen në mënyrë miqësore.

Nëse cilësdo palë i është shkaktuar dëmi si rezultat i mosrespektimit të kësaj marrëveshje, pala dëmtuese duhet të kompensojë, ose dëmshpërblej palën tjetër për masën e dëmit të pësuar.

Nëse palët nuk mund të arrijnë marrëveshje përmes negociatave, vendi i juridiksionit është Prishtina dhe ligji i zbatueshëm është legjislacioni i Kosovës.

CaCH mban të drejtën që të ndërpresë menjëherë kontratën në rast që Komuna nuk arrin të ndajë fondet dhe të sigurojë mbështetje dhe bashkëpunim për zbatimin e aktiviteteve të projektit.

## Neni 8: Zgjatja, amandamentimet

Palët mund të zgjasin apo të ndryshojnë këtë marrëveshje me pëlqim të ndërsjellë dhe në formë të shkruar.

## Article 7: Dispute resolution

All disputes, contradictions, or claims arising out or relating to this agreement shall be resolved amicably, through negotiations, between parties within 30 days.

The parties specifically agree that any material breach of this Agreement may lead to its immediate termination, provided that the parties initially attempt to resolve such non-compliance amicably.

If damage is caused to any of the parties as a result of non-compliance with this agreement, the damaging party should compensate, or indemnify, to the extent of such loss to the other party.

In the event that parties cannot reach an agreement through negotiations, the place of jurisdiction is Prishtina, and applicable law is the Kosovo legislation.

CaCH maintains the right to immediately terminate the contract in cases when the Municipality fails to allocate the funds and provide support and cooperation for the implementation of the project activities.

## Article 8: Extension, amendment

The parties may extend or amend this agreement by mutual consent and in writing form.

| Shqip | English |
|---|---|
| **Neni 9: Përpilimi dhe përkthimi** | **Article 9: Drafting and translation** |
| Të dy palët kanë qenë të barabarta në hartimin dhe shqyrtimin e kësaj marrëveshje përmes këshilltarëve të tyre përkatës ligjor. | Both parties had an equal say in drafting and reviewing this agreement with their respective legal counsel. |
| Marrëveshja është përpiluar në një kopje origjinale dy-gjuhëshe, në gjuhën shqipe dhe gjuhën angleze për secilën palë. Secila palë do të ketë një kopje origjinale në të dy gjuhët (shqip dhe anglisht) të nënshkruar dhe të vulosur. | The agreement is compiled in one original bi-lingual sample in Albanian and English languages for each party. Each party will have a bi-lingual original copy (Albanian and English) signed and stamped. |
| Palët dakordohen që në rast të kontradiktave apo mospërputhjes mes versionit në gjuhën shqipe dhe atij në gjuhën angleze, versioni në gjuhën shqipe do të mbizotërojë. | Parties agree that in case of contradictions or inconsistencies between the versions in Albanian and English languages, the version in the Albanian language shall prevail. |
| **Neni 10: Hyrja në fuqi dhe përfundimi i kësaj marrëveshje** | **Article 10: Entry into force and termination of this agreement** |
| Kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi pas nënshkrimit të saj nga palët dhe do të ekzekutohet deri më 31 Dhjetor 2024 në përputhje me nenin 8 të kësaj marrëveshje. | This agreement shall enter into force upon its signature by the parties and shall be executed until 31 December 2024 in accordance with Article 8 of this agreement. |
| Nënshkruar më 06.02.2023, në komunën e Lipjanit në dy (2) kopje origjinale, secila në të dyja gjuhët (shqip dhe anglisht) dhe me tekst autentik. | Signed on 06.02.2023, in Lipjan Municipality in two (2) original copies, each in two languages (Albanian and English) and authentic texts. |

| | |
|---|---|
| Z./Mr. **Imri Ahmeti**<br>Kryetari i Komunës<br>Mayor<br>________________<br>nënshkrimi<br>signature | Z./ Mr. **Gerhard Schaumberger**<br>Drejtor për Kosovë – Caritasi Zviceran<br>Country Director – Caritas Switzerland<br>________________<br>nënshkrimi<br>signature |
| Z./Mr. **Rasim Hasani**<br>Drejtori i DKA<br>Director of MED<br>________________<br>nënshkrimi<br>signature | Z./ Mr. **Bardh Xërxa**<br>Menaxher i Projektit – Caritasi Zviceran<br>Project Manager – Caritas Switzerland<br>B. Xërxa<br>________________<br>nënshkrimi<br>signature |

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA LIPJAN
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN

| Pranuar me: Primljeno: | 25.01.2023 | |
|---|---|---|
| Njësia Jednica | Numr Broj | Shtojca Dodatak |
| 1-610/01-4464 | | |

Forumi Kosovar i Aftësisë së Kufizuar
Kosovski Forum Invalidnosti
Kosovo Disability Forum
Nr. Prot: Broj Prot: Prot No: 18/23
Data: Datum: Date: 25.01.23
Prishtinë - Priština

Komuna e Lipjanit
Republika e Kosovës

**MEMORANDUM MIRËKUPTIMI**

**I LIDHUR NDËRMJET**

**KOMUNËS SË LIPJANIT**

**DHE**

**FORUMIT KOSOVAR TË AFTËSISË SË KUFIZUAR**

Komuna e Lipjanit, të cilën e përfaqëson kryetari i komunës, z.Imri Ahmeti dhe Forumi Kosovar i Aftësisë së Kufizuar (organizatë ombrellë e organizatave të personave me aftësi të kufizuar në Kosovë, e regjistruar me numrin 5116500-4 në Prishtinë, Republika e Kosovës) i cili përfaqësohet nga z.Bujar Kadriu –Ushtrues Detyre i Drejtorit Ekzekutiv, lidhin këtë memorandum mirëkuptimi, me synim nxitjen e bashkëpunimit në fusha të ndryshme për angazhimin dhe lehtësimin e mësimnxënies për nxënësit me aftësi të kufizuara të cilët mësojnë nëpër shkollat e Komunës së Lipjanit.

Të bindur që ky memorandum mirëkuptimi mundëson vendosjen e urave të bashkëpunimit në fushën e gjithpërfshirjes së nxënësve me aftësi të kufizuara në arsim, duke përfshi qasjen adekuate, mundësi të barabarta, si dhe lehtësimin e mësimnxënies për ta, të drejta këto të garantuar në instrumente ndërkombëtar si Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar si dhe politikat nacionale në Kosovë si Strategjia për Personat me Aftësi të Kufizuara, dhe kësisoj ndikon në cilësinë e mësimeve dhe të jetës së pjesëtarëve të kësaj kategorie.

Këtu e në vazhdim, palëve nënshkruese do t'u referohemi si "Palët" dhe në mënyrë individuale si "Pala".

Palët bien dakord që të respektojnë dispozitat e kësaj marrëveshje të shprehura si më poshtë:

**Neni 1**
**Qëllimi dhe fushëveprimi**

1. Memorandumi i Mirëkuptimit përcakton kushtet për bashkëpunimin dhe përgjegjësitë ndërmjet Palëve.

2. Qëllimi i këtij Memorandumi të Mirëkuptimit është të krijojë një kornizë bashkëpunuese, të lehtësojë dhe të forcojë bashkëpunimin midis Palëve, në mënyrë ekskluzive, në fushën e arsimit, për nxënësit me aftësi të kufizuar, të cilët mësojnë nëpër shkollat e Komunës së Lipjanit.

**Neni 2**

**Përgjegjësitë e palëve**

Palët bien dakord që:

1. Forumi Kosovar i Aftësisë së Kufizuar të mbulojë pagesën e 3 (tre) asistentëve të nxënësve me aftësi të kufizuar, të Komunës së Lipjanit, në kohëzgjatje prej 18 (tetëmbëdhjetë) muajve në shumë prej 416.86€ (katërqind e gjashtëmbëdhjetë euro e tetëdhjetë e gjashtë centë) Bruto, duke filluar nga muaji Shkurt Kjo pagesë bëhet në llogarinë personale të asistentëve të punësuar.

2. Komuna e Lipjanit zotohet se do të angazhohet që t'ia vazhdojë kontratën asistentëve, si nga paragrafi 1 i këtij neni në rast se krijohen fonde të qëndrueshme.

3. Komuna e Lipjanit zotohet që nëpërmjet konkursit publik do t'i rekrutojë asistentët si nga paragrafi 1 i këtij neni, në përputhje me standardet më të mira të rekrutimit dhe të bëjë sistemimin e tyre nëpër shkollat ku ka nevojë.

4. Komuna e Lipjanit zotohet që do të rekrutojë asistentët të cilët parimisht e kanë të përfunduar programin e nivelit 5 të kualifikimit për asistent për fëmijë/nxënës me nevoja të veçanta, sipas U.A 05/2021 për normativin mbi kuadrin profesional mbi arsimin e përgjithshëm. Në mungesë të kualifikimit si më lart, mund të rekrutohen ata që kanë kualifikim të përafërt.

5. Komuna e Lipjanit zotohet që do të ketë transparencë gjatë tërë procesit të rekrutimit të asistentëve, përkatësisht të lejojë që procesi të monitorohet përmes monitoruesve nga Forumi Kosovar i Aftësisë së Kufizuar.

6. Forumi Kosovar i Aftësisë së Kufizuar mund të monitorojë punën e asistentëve të rekrutar, herë pas here.

7. Palët zotohen të mbajnë dhe të ruajnë bashkëpunimin, i cili respekton pavarësinë e tyre profesionale dhe transparencën e veprimtarisë, duke ripërtrirë këtë memorandum në të ardhmen;

8. Të takohen për të diskutuar çështjet me interes të përbashkët.

**Neni 3**
**Fushat prioritare të angazhimit**

1. Palët bien dakord të forcojnë bashkëpunimin e tyre në fushat specifike si më poshtë që ndërlidhen me angazhimin dhe lehtësimin e qasjes dhe mundësive të barabarta për nxënës me aftësi të kufizuara.

    1.1. Korniza ligjore dhe institucionale për gjithëpërfshirjen e nxënësve me aftësi të kufizuara;

    1.2. Të drejtat e personave me aftësi të kufizuara për arsimim në Komunën e Lipjanit.

    1.3. Politika integruese dhe ofrimin e mundësive për studim për këtë kategori përmes përgatitjes së platformave adekuate digjitale nga ana e Forumit Kosovar të Aftësisë së Kufizuar, në bashkëpunim me stafin arsimor të Komunës së Lipjanit.

    1.4. Promovimi i kësaj nisme te stafi arsimor.

**Neni 4**
**Shërbime këshilluese**

1. Palët bien dakord që Forumi Kosovar i Aftësisë se Kufizuar të ketë rol mbështetës dhe këshillues përmes donacioneve dhe/apo projekteve të ndryshme legale në drejtim të Komunës së Lipjanit. Ky rol nënkupton edhe mbështetje me asistencë teknike dhe profesionale, këshilla strategjike dhe lehtësim të realizimit të këtij procesi për Komunën e Lipjanit.

2. Palët bien dakord që do të ndihmojnë personelin arsimor me këshilla teknike dhe shërbime të tjera me marrëveshje ndërmjet palëve;

3. Palët do të angazhohen për të siguruar bashkëpunimin dhe financimin nga palët e treta (d.m.th. nga donatorë ndërkombëtarë dhe kombëtarë), pra kjo bie obligim specifik i të dyja palëve nënshkruese në këtë memorandum mirëkuptimi.

4. Palët do të japin hapësirë në faqet informuese (Web faqet dhe rrjetet sociale) të tyre për aktivitetet e përbashkëta, porsa të filloj zbatimi i këtij aktiviteti.

**Neni 5**
**Kopjet dhe gjuha e memorandumit**

Ky memorandum është e hartuar në dy kopje identike në gjuhën shqipe dhe secila palë nënshkruese merr nga një kopje.

**Neni 6**
**Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

1. Palët zotohen të zbatojnë vullnetarisht dhe në kushte mirëbesimi këtë Memorandumin për sa parashikohet në të. Mosmarrëveshjet zgjidhen me mirëkuptim.

2. Palët kanë të drejtë të ndryshojnë këtë memorandum pas konsultimeve të përbashkëta.

**Neni 7**
**Shkëputja**

Palët nënshkruese mund të kërkojnë ndërprerjen e kësaj marrëveshje, në çdo kohë duke bërë një njoftim me shkrim së paku tridhjetë (30) ditë më herët.

**Neni 8**
**Hyrja në fuqi**

Ky Memorandum Mirëkuptimi hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga palët nënshkruese dhe është i vlefshëm, deri sa palët të kërkojnë me shkrim ndërprerjen e tij.

| Komuna e Lipjanit | Forumi Kosovar i Aftësisë së Kufizuar |
|---|---|
| p/ Imri Ahmeti | Bujar Kadriu |
| Kryetar | UD - Drejtorit Ekzekutiv |
| ____________ | ____________ |
| Nënshkrimi | Nënshkrimi |

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA LIPJAN
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN

| Pranuar me: / Primljeno: | 30.03.2023 | |
| --- | --- | --- |
| Njësia / Jednica | Numri / Broj | Shtojca / Dodatak |
| 1-300/01-16009 | | |

Hilfe zur Selbsthilfe e.V.

*Marrëveshje Bashkëpunimi*
***në mes të:***

*Cooperation Agreement*
***between:***

**Komuna e Lipjanit /Lipjan Municipality**
Me seli ne / *With the registered seat at*
Rr/Str: Rruga "Shqipëria" nr.28, Lipjan
Përfaqësuar nga / *Represented by*
Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës/*Mayor*
(tutje referuar si – „Komuna" *hereinafter "Municipality")*

**dhe / *and***

**Help - Hilfe zur Selbsthilfe e.V.**
Me seli ne / *With the registered seat at*
Prishtine, Ulpiana, rr/str: Zija Shemsiu 102/9
Perfaqesuar nga / *Represented by*
Shqipe Breznica, Drejtoreshe Nacionale/*Country Director*
(tutje referuar si – „Help"; *hereinafter „Help"*)

Në kuadër te projektit
**"Përfshirja dhe Fuqizimi Ekonomik ne Ballkanin Perëndimor"**

*Within the project*
***"Inclusion and Economic Empowerment in the Western Balkans"***

**Neni 1.** / ***Article 1.***
**Subjekt i Marrëveshjes** / ***Subject of the Agreement***

Subjekt i kësaj Marrëveshje të Bashkëpunimit (më tej: MB) është bashkëpunimi në mes të Komunës se Lipjanit dhe Help në kuadër të projektit "Përfshirja dhe Fuqizimi Ekonomik ne Ballkanin Perëndimor" (më tej "Projektit"), i financuar nga qeveria Gjermane, (më tej "Donator") dhe zbatuar nga Help.

Projekti do të realizohet në periudhën kohore 2023 dhe 2024. Komuna e Lipjanit do të bashkë-financojë projektin e lartpërmendur në lidhje me aktivitetet në kuadër të Komunës. Prandaj, Komuna dhe Help do të bashkëpunojnë në çështjet e mëposhtme gjatë zbatimit të projektit:

- Mbështetje për zbatimin e Strategjisë për Zhvillim te Qëndrueshëm ne Komunë
- Mbështetje zhvillimit te ndërmarrësisë dhe ndërmarrjeve të vogla, veçanërisht në funksion të rritjes së punësimit dhe krijimit të vendeve të reja te punës si dhe krijimin e kushteve konkurruese për tërheqjen e investimeve.
- Mbështetje zhvillimit te ndërmarrësisë dhe ndërmarrjeve të vogla, përmes shfrytëzimit më efiçientë të energjisë
- Identifikimi dhe rrjetëzimi me partner brenda kuadrit të projektit me vëmendje të veçantë tek bizneset e vogla.
- Krijimin e drejtpërdrejtë të vendeve te punës

***

*Subject of this Cooperation Agreement (hereinafter: CA) is the cooperation between Lipjan Municipality and Help within the project "Inclusion and Economic Empowerment in the Western Balkans" (hereinafter "Project "), financed by the German government, (hereinafter „Donor ") and implemented by Help.*

*The project will be implemented during 2023 and 2024. Lipjan Municipality will co-finance the aforementioned project regarding activities within the Municipality. Accordingly, Municipality and Help will cooperate on the following issues during the implementation of the project:*

- *Support the implementation of the Strategy for Sustainable Development of the Municipality.*
- *Support the development of entrepreneurship and small enterprises, particularly in the function of employment growth and job creation, and the creation of competitive conditions for attracting investment.*
- *Supporting the development of entrepreneurship and small enterprises, through more efficient use of energy*
- *Identifying and networking partners within the framework of the project with special attention to the micro businesses*
- *Direct job creation*

## Neni 2. / *Article 2.*
## Shpjegim i shkurtër i projektit / *Short explanation of the Project*

Projekti "Përfshirja dhe Fuqizimi Ekonomik ne Ballkanin Perëndimor" synon të rrisë përmirësoje kushtet e jetesës për te margjinalizuarit dhe grupet e cenueshme ne Ballkanin Perëndimor. Qëllimi është krijimi i mekanizmave dhe rrjeteve për fuqizimin e grupeve të margjinalizuara në mënyrë qe te mundësojmë përfshirjen e tyre dhe prosperitetin shoqëror.

Përkrahja do t'u ofrohet grupeve të cenueshme shoqërore, grave, të rinjve, personave me aftësi të kufizuara, dhe komuniteteve lokale përmes fuqizimit ekonomik dhe ndërtimit te aftësive personale dhe profesionale.

Në kuadër të projektit të paktën 20 biznese do të mbështeten në synimet e tyre për të filluar ose zhvillimin e bizneseve. Mbështetja do të përfshijnë:

1) Donacion i pajisjeve te vlerës deri ne 2, 400 Euro
2) Organizimi i trajnimeve te biznesit dhe profesionale sipas nevojave të klientit,
3) Monitorimi i bizneseve të mbështetura.

Zbatimi i aktiviteteve të përmendura do të financohet nga Help ne shumen totale te kostos 88,675.00 Euro ndërsa Komuna do të kontribuojë financiarisht në shumën prej 19,200 Euro në drejtim të realizimit të projektit në kuadër të Komunës.

***

*"Inclusion and Economic Empowerment in the Western Balkans" project aims to improve living conditions or marginalised, vulnerable in the Western Balkans. The objective is to create mechanisms and networks for the empowerment of marginalised groups and thus facilitate their inclusion and social prosperity. The support will be provided to socially vulnerable groups, women, youth, people with disabilities and local communities through economic empowerment involving the building of personal and professional skills.*

*Within the project at least 20 businesses will be supported in their intentions for starting or developing businesses. Support will include:*

1) *Donation of equipment the value up to 2,400 Euro*
2) *Organization of business and vocational trainings according to the client needs,*
3) *Monitoring of the supported micro businesses.*

*The implementation of the above-mentioned activities will be financed by Help in the total amount of expenditure of 88,675.00 Euros, while the Municipality will contribute financially with the amount of 19,200 Euros in the implementation of the project within the Municipality.*

**Neni 3. / *Article 3.***

Komuna do të transferojë ne llogarinë e Help kontributin në shumën prej 19,200 Euro si pjesëmarrje në drejtim të zbatimit të projektit në kuadër të Komunës (tutje "Kontribut"). Kontributi transferohet në një llogari të veçantë të Help (1110339387010117 ne Banken ProCredit), në një këst jo më vonë se 30.06.2023.

Help merr përsipër të përdorë kontributin vetëm për objektivat e Projektit. Help është përgjegjës për zbatimin e projektit dhe Kontributin e dhënë ta përdor ne mënyrë te duhur. Kontributet nga të gjithë Donatorët do të transferohen në një llogari të veçantë të projektit të Help për tu përdorur ekskluzivisht për zbatimin e Projektit. Rregullat e auditimit financiar të donatorit kryesor, këtu Qeverise Gjermane, konsiderohen si ato që mbizotërojnë.

Help merr përgjegjësinë për menaxhimin e përgjithshëm të Projektit dhe është përgjegjëse për zbatimin e përgjithshëm. Help do të zbatojë Projektin në përputhje me rregullat dhe rregulloret aktuale në Republikën e Kosovës dhe me rregullat dhe rregulloret e përcaktuara nga Qeveria Gjermane.

Help do të aplikoj qasje transparente përgjatë zbatimit te projektit ku përfaqësuesi/ja nga Komuna do te jene pjese integrale dhe aktive përgjatë zbatimit te aktiviteteve te projektit.

Bizneset e reja, bizneset e vogla ekzistuese që kanë nevojë për ndihmë shtesë, grupet e komuniteteve jo shumice, gra të papuna, të rinjtë, personat me aftësi të kufizuara dhe kategoritë me më pak mundësi të punësimit do të ju jepet përparësi në realizueshmërinë e ideve te sugjeruara te biznesit.

***

*Municipality will transfer to Help a contribution in the amount of 19,200 Euro as participation towards the implementation of the Project within Municipality (hereinafter: "Contribution"). The contribution will be transferred to a separate account of Help number 1110339387010117 with ProCredit Bank, in one instalment no later than 30.06.2023.*

*Help undertakes to use the Contribution solely for the objectives of the Project. The contributions from all Donors will be transferred to a separate project account of Help used exclusively for the implementation of the Project. The financial auditing regulations of the main donor, here the German government, are considered as the prevailing ones.*

*Help will undertake responsibility for the overall management of the Project and will be responsible for the overall implementation. Help will implement the Project according to the current rules and regulations in the Republic of Kosovo and the rules and regulations established by the German government.*

*Help will apply transparent approach during the whole implementation of the project. Representative from Municipality will be active and integral part of the activity implementation of the project.*

*Start-up businesses, existing small businesses in need for additional assistance, vulnerable minority groups, unemployed women, youth, disabled persons, and less employable categories will be given special consideration depending on viability of the suggested business ideas.*

**Neni 4.** ***/ Article 4.***

**Monitorimi dhe Raportimi** ***/ Monitoring and Reporting***

Palët emërojnë stafin për monitorimin e këtij projekti. Në lidhje me aktivitetet në kuadër të Komunës, Help do të paraqesë një raport përfundimtar (narrativ dhe financiar), brenda tre muajve nga data e përfundimit të Projektit. Palët bien dakord për shkëmbimin e informacionit në kuadrin e Projektit gjatë gjithë kohës gjatë zbatimit të tij.

***

*Parties nominate staff for the monitoring of this Project. Regarding activities within Municipality Help will submit a final report (narrative and financial) within three months from the completion of the Project. Parties agree to always exchange information within the framework of the Project during its implementation.*

**Neni 5.** ***/ Article 5.***

**Klauzolë në konfidencialitet** ***/ Clause on confidentiality***

Të dyja palët bien dakord për konfidencialitetin e të gjitha të dhënave të përdorura brenda kuadrit të bashkëpunimit. Të gjitha dokumentet dhe informatat do të mbeten vetëm për përdorim të brendshëm dhe nuk mund të përdoren për qëllime të tjera, pa miratimin me shkrim nga Help dhe Komuna.

***

*Both parties agree on the confidentiality of all data used within the frame of the cooperation. All documents and information shall remain for internal use only and cannot be used for other purposes without written approval from Help and Municipality.*

**Neni 6.** ***/ Article 6.***

**Kohëzgjatja, ndryshimet e MB** ***/ Duration, changes of the CA***

Marrëveshja do të hyjë në fuqi ditën e nënshkrimit të saj dhe do të përfundojë në 31 dhjetor 2024 me mundësi të ndryshohet dhe të amandamentohet me anekset e shkruara siç është propozuar nga nënshkruesit.

***

*The Agreement will come into force on the day of its signing and will expire on 31 December 2024 with the possibility to be changed and amended by written annexes, as proposed by the signatories.*

***Neni 7. / Article 7.***

**Mosmarrëveshjet** ***/ Disputes***

Çdo mosmarrëveshje ndërmjet nënshkruesve te kësaj marrëveshjeje do të zgjidhen ne mënyrë miqësore me marrëveshje të përbashkët dhe në vullnet të mirë. Nëse një zgjidhje miqësore nuk mund të arrihet të gjitha mosmarrëveshjet do të zgjidhen përfundimisht para gjykatës kompetente në Prishtine.

***

*Any disputes between the signatories arising out of this agreement shall be settled amicably by mutual agreement and in goodwill. If an amicable settlement cannot be reached all disputes shall be finally settled before the competent court in Prishtina.*

**Neni 8.** ***/ Article 8.***

**Gjuha** ***/ Language***

Kjo marrëveshje është përgatitur në dy gjuhë (shqip dhe anglisht) dhe e nënshkruar në dy kopje identike, të cilat secili nënshkrues mban nga një kopje.

***

*This agreement has been prepared parallel in two languages (Albanian and English), and signed in two identical copies, of which each signatory retains one.*

Data/*Date*: 30.03.2023

Në/in Lipjan,

Për Komunën e Lipjanit /
*For Lipjan Municipality*
Imri Ahmeti
Kryetar i Komunës/*Mayor*

Për Help / *For Help*
Për: Shqipe Breznica
Drejtoreshë Nacionale/
*Country Director*

Komuna e Lipjanit

REPUBLIKA E KOSOVES
KOMUNA LIPJAN
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN

| Pranuar me: / Primljeno: | 22.06.2023 | |
|---|---|---|
| Njësia / Jednica | Numri / Broj | Shtojca / Dodatak |
| 1-400/01- | 32317 | |

Humanity First
*Serving Mankind*

Memorandum mirëkuptimi
lidhur ndërmjet
**Komunës së Lipjanit**
dhe
**Humanity First**

Për furnizimin me produkte të mishit për **60 familje** në nevojë të Komunës së Lipjanit.

**Lipjan, Qershor 2023**

**Qëllimi**

1. Qëllimi i Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Komunës së Lipjanit dhe Humanity First është furnizimi me produkte të mishit të cilat do t'u shpërndahen familjeve në nevojë dhe që jetojnë me asistencë sociale në Komunën e Lipjanit.

**Lloji i donacionit**

1. Gjithsej do të shpërndahen **60 pako**. Për çdo familje do të shpërndahet një pako me produkte të mishit. Një pako peshon 5kg dhe përmban: 2kg mish tul, 1kg sugjuk, 1kg qofte dhe 1kg qebapa. 1 Pako ka vlerë rreth 35 euro.

**Orari i implementimit të donacionit**

1. Në pajtim me të dyja palët e lidhjes së këtij memorandumi mirëkuptimi është caktuar që shpërndarja e pakove me produkte të mishit të bëhet **ditën e hënë më datë: 26.06.2023, në orën 15:00.**

**Komuna e Lipjanit zotohet për të ofruar mundësitë e mëposhtme:**

1. Për komisionin prej tre anëtarësh që do të bëjnë përgatitjen e listës së **60 familjeve** në nevojë që janë pranuese të donacionit, do të caktojë një anëtar. Anëtari icaktuar është: Rizmi Jashari
2. Të jenë të përpiktë në respektim të orarit dhe datës së caktuar të shpërndarjes së pakove ushqimore;
3. Angazhon së paku një zyrtar social për të ndihmuar shpërndarjen e pakove në terren;
4. Monitoron shpërndarjen e pakove me produkte mishi dhe kujdeset të regjistrojë emrin dhe mbiemrin e përfituesit, numrin e anëtarëve të shtëpisë së përfituesit, numrin personal të përfituesit, vendbanimin dhe nënshkrimin e përfituesit.

1. Për komisionin prej tre anëtarësh që do të bëjnë përgatitjen e listës së **60 familjeve** pranuese të donacionit që janë në nevojë dhe me asistencë sociale, do të caktojë dy anëtarë. Anëtarët e caktuar janë:
    1. Alban Zeqiraj
    2. Jinahuddin Saif
2. Përmes ndërmarrjes private ETC siguron produktet e mishit;
3. Përmes ndërmarrjes private ETC siguron transportimin e produkteve të mishit me automjet frigodhomë që i mban të freskëta produktet e mishit gjatë transportimit dhe shpërndarjes;
4. Të jenë të përpiktë në respektim të orarit dhe datës së caktuar të shpërndarjes së pakove me produkte të mishit;
5. I përmbahet të gjitha zotimeve të marra përsipër në këtë marrëveshje.

**Dispozita përfundimtare**

1. Ky memorandum është nënshkruar në katër (4) kopje origjinale, në gjuhën shqipe.

**Hyrja në fuqi**

Memorandumi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga palët, ndërkohë zbatimi i saj fillon me datë **26.06.2023, ora 15:00**.

Vendtakimi i fillimit të shpërndarjes së pakove me produkte të mishit është: **te tregu i ri, Lipjan**.

**Lipjan**
**Datë:** ___________

Komuna e Lipjanit

Humanity First

REPUBLIKA E KOSOVES
KOMUNA LIPJAN
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN

| Pranuar me: Primljeno: | 13.03.2023 | |
|---|---|---|
| Njesia Jednica | Numri Broj | Shtojca Dodatak |
| 1-115/01-12725 | | |

# MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

Ndërmjet

Projekti: **"INTEGRA - Nxitja e riintegrimit të qëndrueshëm lokal të grave dhe të rinjve të kthyer dhe njerëzve të cenueshëm lokalë në Kosovë"**

i përfaqësuar nga

**Fondacioni për Zhvillim të Qëndrueshëm Ekonomik - PREDA Plus Kosovë**

**dhe**

**WEntrepreneur**

më tutje - Autoriteti Zbatues

dhe

**Komuna e Lipjanit**

më tutje - Komuna Partnere

Mars, 2023

## Hyrje

Projekti "Nxitja e riintegrimit të qëndrueshëm lokal të grave dhe të rinjve të kthyer dhe njerëzve të cenueshëm lokalë në Kosovë" i njohur gjithashtu si INTEGRA është një projekt i financuar përmes "Perspektive Heimat" ose "Perspektiva Atdhe" i cili synon të mbështesë të kthyerit dhe popullsinë e cenueshme lokale, për të bërë një fillim të ri. në vendin e tyre të origjinës. Projekti financohet nga Ministria Gjermane për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik – BMZ dhe po zbatohet nga Fondacioni për Zhvillim të Qëndrueshëm Ekonomik – PREDA Plus Kosovë në partneritet me WEntrepreneur Kosovë dhe me mbështetjen e Arbeiter Samariter Bund – ASB. Projekti ka filluar më 1 dhjetor 2022 dhe do të zbatohet deri më 31 gusht 2025.

INTEGRA synon integrimin social dhe ekonomik në vendin e origjinës të të kthyerve, si dhe grupeve në rrezik, që do të kenë një perspektivë për të qëndruar, nëpërmjet ngritjes së kapaciteteve, punësimit dhe vetëpunësimit, që do t'u mundësojë atyre të gjenerojnë të ardhura për familjet e tyre dhe të ndërtojnë jetën e tyre në Kosovë. Një veprim i tillë është i rëndësishëm si nga këndvështrimi i integrimit social ashtu edhe nga këndvështrimi i ndjeshmërisë ndërkombëtare lidhur me çështjet e migracionit.

## Neni 1. Qëllimi

Qëllimi i këtij Memorandumi për Bashkëpunim (MB) është të sigurojë një kornizë për bashkëpunimin e ardhshëm ndërmjet palëve, duke përshkruar përgjegjësitë dhe angazhimin e ndërsjellë për të mirën e një zbatimi të suksesshëm të Projektit.

## Neni 2. Fushat e Bashkëpunimit

Projekti INTEGRA do t'i përgjigjet nevojave të grave dhe të rinjve të kthyer dhe personave nga grupet në rrezik që do të kenë një perspektivë për të qëndruar në koordinim të ngushtë me Komunën e Lipjanit.

Fushat e bashkëpunimit përshkruhen përmes Komponentës së Projektit e cila parashikohet të zbatohet sipas kësaj nisme:

Mbështetja e themelimit të bizneseve fillestare – 6 biznese fillestare nga Komuna e Lipjanit që promovojnë ide krijuese: do të jenë biznese të sapo regjistruara që kanë ide krijuese për produkte dhe shërbime, të cilat aktualisht janë të kufizuara ose inekzistente në tregjet lokale. 6 Biznese fillestare të tilla do të mbështeten përmes një Skeme specifike të Granteve, para se gjithash këta persona kanë qenë të nënshtruar trajnimit të detyrueshëm, në mënyrë që të konkurrojnë për këto grante. Secila nga 6 bizneset fillestare nga Komuna e Lipjanit kanë aplikuar përmes një procesi të Skeme të Granteve "Mbështetja e Grave dhe të Rinjve të Riatdhesuar në themelimin e bizneseve individuale" me Nr. Reference KOS2202-C2 dhe janë nënshtruar procesit të vlerësimit. Këto biznese do të duhet gjithsecili të punësojnë, së paku nga një (1) person.

## Neni 3. Kushtet e financimit

Në këtë fazë të Projektit, 6 biznese fillestare nga Komuna e Lipjanit janë përzgjedhur dhe do të financohen së bashku nga Projekti INTEGRA dhe Komuna e Lipjanit në total prej 15,000.00 euro.

Pas vlerësimit të aplikimeve, Komisioni i Vlerësimit identifikoi përfituesit e mëposhtëm për t'u ndarë fonde:

| | Emri dhe Mbiemri | Numri personal | Adresa |
|---|---|---|---|
| 1 | Shkurte Fazliu | 1174247435 | Rr. Tahir Sinani 48 - Lipjan |
| 2 | Mimoza Sopa | 1234390984 | Rr. Ganimete Tërbeshi pn - Lipjan |
| 3 | Fjolla Llugiqi | 1248226877 | Rr. Zylfije Gashi 100 - Lipjan |
| 4 | Egzon Drenica | 1243112296 | Rr. Haradin Bajrami pn - Lipjan |
| 5 | Mevlide Banushi | 2003864947 | Rr. Zylfije Gashi pn - Lipjan |
| 6 | Kastriot Hashani | 1240696734 | Fshati Gadime e Ulët - Lipjan |

## Neni 4. Përgjegjësitë e Palëve

4.1. Në përputhje me rezultatet e pritshme të përshkruara në Nenin 2, Projekti INTEGRA do të sigurojë një zbatim të suksesshëm të të gjitha aktiviteteve duke:

- Ofruar Ndihmën Profesionale për bizneset përfituese nga projekti.
- Siguruar aftësimin e personave/përfituesve të Projektit, të cilat do të rriten në një nivel të kënaqshëm.
- Për të zhvilluar me procedim publik tenderues për pajisjet e kërkuara nga ana e bizneseve përfituese.
- Shpërndarjen e këtyre mjeteve si dhe monitorimin.

4.2. Vlera e participimit të Projekti INTEGRA si pjesë e bashkëfinancimit do të jetë 84.00% të vlerës totale apo 12,600.00 euro.

4.3. Komuna e Lipjanit do të sigurojë ekzistencën e një niveli dhe cilësie të mjaftueshme e informacioneve që do t'i ofrohen Palëve, për nevojat e zbatimit të aktiviteteve të Projektit. Në raste kur paraqitet nevoja, Komuna do të ofrojë personelin e saj në mënyrë që të ndihmojnë në zbatim të suksesshëm të aktiviteteve të Projektit.

4.4. Vlera e participimit të Komunës së Lipjanit si pjesë e bashkëfinancimit do të jetë 8.00% të vlerës totale apo 1,200.00 euro.

4.5. Të gjitha bizneset e reja do të sigurojnë 8.00% të fondeve në formë bashkëfinancimi. Shuma totale që përfituesit do të kontribuojnë si pjesë e bashkëfinancimit do të jetë 1,200.00 euro, ndërsa çdo bashkëfinancim individual do të jetë në vlerë 200.00 euro.

4.6. Të gjitha aktivitetet për realizimin e Projektit INTEGRA do të zbatohen dhe monitorohet nga ana e PREDA Plus në partneritet me WEntrepreneur Kosovë dhe me mbështetjen e Arbeiter Samariter Bund - ASB, Këln, Gjermani.

**Neni 5. Hyrja në fuqi**

Ky Memorandum hyn në fuqi, në datën e nënshkrimit dhe zgjat deri më 31. Gusht. 2025, datë kjo që paraqet edhe fundin e Projektit.

**Neni 6. Përfundimi**

Secila palë mund ta ndërpresë këtë bashkëpunim duke i dhënë palës tjetër, një njoftim tridhjetë (30) ditësh me shkrim. Në rast të ndërprerjes së pjesëshme, njoftimi i tillë do të përcaktojë se cilat fusha të ndihmës janë prekur.

**Neni 7. Gjuha**

Ky Memorandum është përgatitur në tri origjinale, një në Gjuhën Angleze dhe dy në Gjuhen Shqipe. Autoriteti Zbatues do të merr një origjinal në Gjuhën Angleze dhe një në Gjuhën Shqipe ndërsa Komuna Partnere do ta merr një origjinal në Gjuhën Shqipe.

**Palët Nënshkruese:**

**Në emër të Autoritetit Zbatues:**

Emri: Valentin Hoxha

Titulli: Drejtor i Projektit

Nënshkrimi: [signature; stamp: Foundation for sustainable economic development PREDA Plus]

Data: 08.03.2023

**Në emër të Komunës Partnere**

Emri: Imri Ahmeti

Titulli: Kryetar

Komuna: Lipjanit

Nënshkrimi: [signature; stamp: Republika e Kosovës, Komuna e Lipjanit – Republika Kosovo, Opština Lipljan, Lipjan]

Data: 13.03.202[3]

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA LIPJAN
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN
01 Nr.Br. 300/01-2466
Data/Datum 13.01.2023



# MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

Ndërmjet

Projekti: **"INTEGRA - Nxitja e riintegrimit të qëndrueshëm lokal të grave dhe të rinjve të kthyer dhe njerëzve të cenueshëm lokalë në Kosovë"**

i përfaqësuar nga
**Fondacioni për Zhvillim të Qëndrueshëm Ekonomik - PREDA Plus Kosovë**
**dhe**
**WEntrepreneur**

më tutje - Autoriteti Zbatues

dhe

**Komuna e Lipjanit**

më tutje - Komuna Partnere

**Hyrje**

Projekti "Nxitja e riintegrimit të qëndrueshëm lokal të grave dhe të rinjve të kthyer dhe njerëzve të cenueshëm lokalë në Kosovë" i njohur gjithashtu si INTEGRA është një projekt i financuar përmes "Perspektive Heimat" ose "Perspektiva Atdhe" i cili synon të mbështesë të kthyerit dhe popullsinë e cenueshme lokale, për të bërë një fillim të ri. në vendin e tyre të origjinës. Projekti financohet nga Ministria Gjermane për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik – BMZ dhe po zbatohet nga Fondacioni për Zhvillim të Qëndrueshëm Ekonomik – PREDA Plus Kosovë në partneritet me WEntrepreneur Kosovë dhe me mbështetjen e Arbeiter Samariter Bund – ASB. Projekti ka filluar më 1 dhjetor 2022 dhe do të zbatohet deri më 31 gusht 2025.

INTEGRA synon integrimin social dhe ekonomik në vendin e origjinës të të kthyerve, si dhe grupeve në rrezik, që do të kenë një perspektivë për të qëndruar, nëpërmjet ngritjes së kapaciteteve, punësimit dhe vetëpunësimit, që do t'u mundësojë atyre të gjenerojnë të ardhura për familjet e tyre dhe të ndërtojnë jetën e tyre në Kosovë. Një veprim i tillë është i rëndësishëm si nga këndvështrimi i integrimit social ashtu edhe nga këndvështrimi i ndjeshmërisë ndërkombëtare lidhur me çështjet e migracionit.

**Neni 1. Qëllimi**

Qëllimi i këtij Memorandumi për Bashkëpunim (MB) është të sigurojë një kornizë për bashkëpunimin e ardhshëm ndërmjet palëve, duke përshkruar përgjegjësitë dhe angazhimin e ndërsjellë për të mirën e një zbatimi të suksesshëm të Projektit.

**Neni 2. Fushat e Bashkëpunimit**

INTEGRA synon drejtpërdrejt individë si gra dhe të rinj të kthyer dhe persona nga grupet në rrezik që do të kenë një perspektivë për të qëndruar, por edhe zyrtarë të qeverive lokale dhe qendrore. Përveç kësaj, sa herë që është e mundur, projekti do të sigurojë angazhimin dhe bashkëpunimin e komuniteteve përkatëse.

Projekti ka 5 komponentë kryesorë të cilët janë të ndërlidhur për të siguruar arritjen e objektivit të projektit:

**Komponenti 1. Forcimi i kapaciteteve dhe shkëmbimi i përvojave ndërmjet 35 përfaqësuesve të pushtetit lokal dhe qendror**

Ky aktivitet paraqet një pjesë të rëndësishme të projektit pasi ndërton/rrit aftësitë e zyrtarëve të qeverisë lokale dhe qendrore dhe u ofron atyre mundësinë për të ndarë përvojën e tyre në punën e përditshme me të kthyerit dhe nevojat e tyre më urgjente. Ata do t'i bashkohen Ekipit të Projektit në hartimin e Skemave të Granteve për të kthyerit, por gjithashtu do të marrin pjesë në vizitat

monitoruese. Kjo do t'i ndihmojë ata që në të ardhmen, të nisin dhe/ose menaxhojnë skema të tjera të tilla, të financuara nga Qeveria e Kosovës ose komunat përkatëse.

**Komponenti 2. Ndërtimi i aftësive i 120 personave të kthyer dhe personave nga grupet në rrezik, në Planifikimin dhe Menaxhimin e Biznesit dhe sigurimi i të mirave materiale/kapitale për 100 biznese të reja**

Përfitues të këtij aktiviteti janë kryesisht gratë dhe të rinjtë e kthyer, por edhe personat nga grupet në rrezik, të interesuara për të krijuar biznesin e tyre. Mbështetje në formën e pajisjeve do t'u ofrohet individëve që vijnë me ide novatore; mbulojnë sektorë të mangët në tregun vendas, ose ofrojnë shërbime dhe produkte që zëvendësojnë ato që importohen dhe ato që janë miqësore me mjedisin. Shembuj të llojeve të profesioneve/ideve të biznesit që do të mbështeten, janë: dizajnerët, specialistët e IT-së, zhvilluesit e uebit, kultivuesit e ushqimit organik, përpunuesit e ushqimit etj.

**Komponenti 3. Sigurimi i kompetencave dhe rikualifikimi i 50 përfituesve të përzgjedhur përmes Trajnimit të Arsimit Profesional**

Mungesa e profesioneve specifike në Kosovë po bëhet gjithnjë e më evidente. Për të adresuar këtë problem, Projekti planifikon të identifikojë individë që janë të interesuar të plotësojnë këto boshllëqe, por edhe të gjenerojnë të ardhura të qëndrueshme.

Projekti synon të tërheqë individë që janë të interesuar të kualifikohen për sektorë të mangët, por edhe për ata që dëshirojnë të rikualifikohen dhe të zotërojnë një gamë të re aftësish.

**Komponenti 4. Ofrimi i mundësive të punësimit të lehtësuar në kompanitë ekzistuese, për 60 përfitues**

Përmes këtij aktiviteti, Projekti synon t'u ofrojë punësim solid 60 grave dhe të rinjve të kthyer, në industritë që kanë më shumë nevojë për to. Angazhimi i tyre mund të jetë me një punëdhënës të vetëm ose të më shumë të tillë. Poashtu, ngritja e kapaciteteve të tyre, do të varet nga aktiviteti ku do të angazhohen. Projekti do t'u ofrojë punëdhënësve mbështetje në formën e pajisjeve, për çdo përfitues të punësuar.

**Komponenti 5. Krijimi i 5 Qendrave të Angazhimit të Komunitetit (QAK)**

Projekti synon të mbështesë komunitetet në të cilat jetojnë të kthyerit dhe grupet në rrezik. Për të plotësuar nevojat e grupeve të synuara, projekti do të krijojë Qendrat e Angazhimit të Komunitetit (QAK), në 5 komuna të ndryshme. QAK paraqet një qendër për reflektim dhe edukim, në të cilën gratë identifikojnë temat sipas përzgjedhjes së tyre dhe angazhohen rregullisht në aktivitetet e planifikuara. QAK do të shërbejë si një hapësirë e sigurt për gratë për të diskutuar tema të ndryshme duke përfshirë ato që përndryshe nuk do të ndiheshin rehat t'i diskutonin për shkak të ndjeshmërisë kulturore. Në QAK do të organizohen seminare, tubime sociale dhe ngjarje të tjera për të promovuar dhe përkrahur qytetarinë aktive përmes bashkëpunimit dhe ndërveprimit me komunitetin.

Themelimi i qendrave të tilla është subjekt i një procesi konkurrues ndërmjet të gjitha komunave përfituese.

## Neni 3. Përgjegjësitë e Autoritetit Zbatues

Në përputhje me komponentët dhe rezultatet e pritshme të përshkruara në Nenin 2, Autoriteti Zbatues do të sigurojë një zbatim të suksesshëm të të gjitha aktiviteteve duke:

- Ofruar Ndihmën Profesionale për përfituesit e projektit dhe Komunat Partnere.
- Siguruar aftësimin e personave/përfituesve të Projektit, të cilat do të rriten në një nivel të kënaqshëm.
- Zbatuar praktikat më të mira në Zhvillimin e Biznesit dhe mbështetjes për bizneset filestare.
- Ofruar bizneseve ekzistuese qasje në njohuri të avancuara.
- Zbatuar gjatë gjithë kohës, nivel të lartë të transparencës dhe paanshmërisë.

## Neni 4. Përgjegjësitë e Komunës Partnere

Komunat Partnere do të sigurojë ekzistencën e një niveli dhe cilësie të mjaftueshme e informacioneve që do t'i ofrohen Autoritetit Zbatues, për nevojat e zbatimit të aktiviteteve të Projektit. Në raste kur paraqitet nevoja, Komuna Partnere do të ofrojë personelin e saj në mënyrë që të ndihmojnë në zbatim të suksesshëm të aktiviteteve të Projektit.

## Neni 5. Natyra jo-kontraktuale e marrëdhënieve

Palët bien dakord që ky Memorandum përfaqëson Mirëkuptimin e ndërsjellë dhe nuk është menduar dhe as nuk do të konsiderohet si kontratë dhe nuk do të krijojë asnjë të drejtë dhe detyrim sipas kontratës. Asgjë që përmbahet këtu nuk do të interpretohet në mënyrë që të përbëjë një partneritet sipërmarrësie të përbashkët ose një organizatë formale biznesi të çfarëdo lloji ndërmjet Palëve ose në mënyrë që të përbëjë njëra Palë si agjent i tjetrit.

Palët pranojnë që ky Memorandum nuk sjell në asnjë mënyrë ndonjë të drejtë ose leje për t'u përdorur ose për t'u lidhur me pronën intelektuale të secilës Palë.

## Neni 6. Hyrja në fuqi

Ky Memorandum hyn në fuqi, në datën e nënshkrimit dhe zgjat deri më 31. Gusht. 2025, datë kjo që përfaqëson edhe fundin e Projektit.

## Neni 7. Përfundimi

Secila palë mund ta ndërpresë këtë bashkëpunim duke i dhënë palës tjetër, një njoftim tridhjetë (30) ditësh me shkrim. Në rast të ndërprerjes së pjesëshme, njoftimi i tillë do të përcaktojë se cilat fusha të ndihmës janë prekur.

## Neni 8. Gjuha

Ky Memorandum është përgatitur në tri origjinale, një në Gjuhën Angleze dhe dy në Gjuhen Shqipe. Autoriteti Zbatues do të merr një original në Gjuhën Angleze dhe një në Gjuhën Shqipe ndërsa Komuna Partnere do ta merr një original në Gjuhën Shqipe.

**Palët Nënshkruese:**

**Në emër të Autoritetit Zbatues:**

Emri: Valentin Hoxha

Titulli: Drejtor i Projektit

Nënshkrimi: [signature]

Data: 13.01.2023

**Në emër të Komunës Partnere**

Emri: Imri Ahmeti

Titulli: Kryetar

Komuna: Lipjan

Nënshkrimi: [signature]

Data: 13.01.2023

DALËSE - IZLAZNA - OUTGOING
REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. Br. No. 454-142/18 -IV-
Data. Datum. Date. 14.03.2023

HELVETAS
KOSOVO

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*
*Ministria e administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administration*

Prishtinë, 2023

Në mbështetje të nenit 8, 9, 10, 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, nenit 8 paragrafi 1.4, të Rregullores (QRK) - Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenin 5 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Ligjin Nr. 08/l-103 për Sistemin e Menaxhimit të Performancës së Komunave dhe skemën e grantit të bazuar në performancë, si dhe Ligjin Nr. 08/L-193 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, Marrëveshjen e kritereve për financimin e projekteve midis MAPL dhe DEMOS të datës 28.02.2023, si dhe duke u bazuar në Raportin vlerësues për Grantin e Performancës Komunale për vitin 2021 periudha e alokimit 2023 të aprovuar nga Komisioni i Grantit për Performancë Komunale me dt. 17.10.2022, arrihet kjo:

## MARRËVESHJE PËR MBËSHTETJE FINANCIARE TË PROJEKTIT "NDËRTIMI I SHTRATIT TË LUMIT DHE ASFALTIMI I RRUGËS SË LUMIT NË FSHATIN GADIME E ULËT" NGA SKEMA E GRANTIT PËR PERFORMANCË KOMUNALE

**Ndërmjet:**

1. Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, përfaqësuar nga Ministri i MAPL-së (në tekstin e mëtejmë MAPL),

2. Helvetas Swiss Intercooperation, përfaqësuar nga Menaxheri i Projektit DEMOS (në tekstin e mëtejmë DEMOS) dhe,

3. Komunës së Lipjani, përfaqësuar nga Kryetari i Komunës (në tekstin e mëtejmë Komuna).

### Neni 1
### Qëllimi

1. Palët nënshkruese të kësaj marrëveshje kanë për qëllim financimin e projektit duke u kujdesur për zbatimin e kritereve, parimeve, procedurave dhe rregullave ligjore të bashkëfinancimit dhe shpenzimit të mjeteve materiale konform dispozitave të kësaj marrëveshje.

2. Marrëveshja parasheh të drejtat dhe detyrimet e palëve në respektimin e rregullave të përcaktuara për bashkëfinancim të projektit, afatet dhe kushtet e tjera kontraktuale për

subjektet juridike, me qëllim të shfrytëzimit të drejtë të grantit të performancës komunale dhe rritjes së efikasitetit të komunave në qeverisjen demokratike, menaxhimin komunal dhe ofrimin e shërbimeve cilësore për qytetarë.

## Neni 2
## Objekti i Marrëveshjes

1. Kjo marrëveshje ka për objekt bashkëfinancimin e projektit si vijon:

**Ndërtimi i shtratit të lumit dhe asfaltimi i rrugës së lumit në fshatin Gadime e Ulët**

## Neni 3
## Vlera e projektit dhe mënyra e bashkëfinancimit

1. Shuma totale e projektit në vlerën e parallogaritur është € 315,000.00

2. Shuma totale e ndarë nga buxheti i MAPL-së për këtë projekt është € 270,000.00

3. Shuma totale e ndarë nga buxheti i DEMOS për këtë projekt është € 0.00

4. Komuna nga buxheti i saj financon këtë projekt në shumën prej € 45,000.00

5. Çfarëdo vlere tjetër që tejkalon shumën e paracaktuar të projektit, financohet nga buxheti i komunës.

## Neni 4
## Të drejtat dhe detyrimet e MAPL-së

1. MAPL në zbatim të marrëveshjes për kriteret e financimit të projekteve të Grantit të Përformancës Komunale ( GPK) të datës 28 shkurt 2023 zotohet që:

a) Të sigurojë zotimin e mjeteve financiare sipas nenit 3.2 e kësaj marrëveshjeje. Një kopje e zotimit të mjeteve i dërgohet komunës. Të kryej obligimet financiare në bazë të realizimit të punimeve/furnizimeve sipas kushteve të kontratës.

b) Të monitoroj projektin në vazhdimësi dhe bashkëpunon me komunën për implementimin e kushteve të kontratës.

2. MAPL përmes monitoruesit është në kontakt të vazhdueshëm me komunën për këtë projekt dhe në rast se vëren parregullsi apo defekte gjatë realizimit të kontratës/projektit njofton Sekretarin e Përgjithshëm të MAPL-së, i cili ndërmerr hapat në pajtim me legjislacionin në fuqi.

3. MAPL rezervon të drejtën të ndërpresë këtë Marrëveshje dhe të ndërmarrë hapa të mëtutjeshëm sipas legjislacionit në fuqi, në rast se vërtetohet nga raporti i Auditorit të Përgjithshëm, i cili është kërkuar për Grantin e Performancës Komunale për vitin 2021, se komuna ka raportuar të dhëna të pasakta apo fiktive të cilat kanë ndikuar në përfitimin e Grantit të Performancës. Në këtë rast të gjitha përgjegjësitë për këtë projekt i takojnë komunës respektive.

4. MAPL nuk mban përgjegjësi në rast të dështimit të projektit për shkaqe të cilat nuk ndërlidhen me autorizimet e saj, si dhe në rast të ndryshimeve të mundshme të çfarëdo natyre ose shkeljeve që mund të ndodhin gjatë zbatimit të projektit që është në përgjegjësi të komunës.

### Neni 5
### Të drejtat dhe detyrimet e DEMOS

1. DEMOS në zbatim të marrëveshjes për kriteret e financimit të projekteve të GPK-së të datës zotohet të siguroj transferin në buxhetin e komunës të shumës financiare të paraparë për projektin sipas nenit 3.3 të kësaj marrëveshjeje.

2. DEMOS, në rast se është financues i projektit, mund të kërkoj informata nga komuna rreth projektit nëse e konsideron të nevojshme. Po ashtu mund të kërkohen informata nga MAPL lidhur me monitorimin e projektit.

3. DEMOS nuk mban përgjegjësi në rast të dështimit të projektit për shkaqe të cilat nuk ndërlidhen me autorizimet e saj, si dhe në rast të ndryshimeve të mundshme të çfarëdo natyre ose shkeljeve që mund të ndodhin gjatë zbatimit të projekteve që është në përgjegjësi të komunës.

### Neni 6
### Të drejtat dhe detyrimet e komunës

1. Komuna obligohet të jap kontributin e saj financiar për zbatimin e projektit në shumën e përcaktuar në nenin 3.4 të kësaj marrëveshjeje.

2. Në rast kur financimi i projektit bëhet nga MAPL, komuna pas nënshkrimit të kësaj marrëveshje, obligohet të dërgoj në MAPL informatat e nevojshme për hartimin e PiP (Projekti i Investimeve Publike) me qëllim të zotimit të mjeteve të dala nga kjo marrëveshje, sipas Nr. 08/L-193 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023.

3. Nëse pas procedurave të prokurimit, shuma e projektit rezulton më e ulët se vlera e paracaktuar në nenin 3.1 të marrëveshjes, komuna është e detyruar të zvogëlojë kontributin e saj, ndërsa shuma e GPK-së mbetet e njëjtë deri në përmbushjen e vlerës së projektit, ndërsa pjesa e mbetur nga shuma e GPK-së kthehet.

4. Komuna obligohet të zhvillojë projektin në përputhje me këtë marrëveshje dhe kornizën ligjore në fuqi.

5. Në rast kur financimi i projektit bëhet nga MAPL, komuna obligohet që pas nënshkrimit të kontratës me Operatorin Ekonomik (OE), të sjellë në MAPL një kopje të kontratës dhe ofertën financiare identike me origjinalin, së bashku me informatat për biznesin me qëllim të nxjerrjes së urdhër blerjes, si vijon:

- çertifikatën për regjistrimin e biznesit;
- çertifikatën e numrit fiskal;
- kopjen e kartelës bankare të OE ose vërtetimi nga banka;
- kopjen e dokumentit identifikues të pronarit të biznesit.

6. Në rast kur financimi i projektit bëhet nga DEMOS, komuna obligohet që të informojë MAPL-në dhe DEMOS-in për vlerën finale të projektit pas përfundimit të procedurave të

prokurimit dhe të dërgoj një kopje të kontratës, ofertën financare dhe raportit të vlerësimit të tenderit.

7. Komuna cakton projekt menaxherin/organin mbikëqyrës për mbikëqyrjen e kryerjes së punimeve dhe komisionin i cili lëshon certifikatën e pranimit të punimeve/pranimin teknik.

8. Projekt menaxheri/organi mbikëqyrës me përgjegjësi të plotë, vërteton sasitë dhe kualitetin e punëve/furnizimeve të kryera, në bazë të cilave operatori ekonomik lëshon dokumentin financiar (faturën), me kërkesën për realizimin e pagesës të punimeve/furnizimeve të kryera, duke iu referuar kushteve të kontratës.

9. Komuna është e detyruar t'ia sigurojë MAPL-së dhe DEMOS-it kopjet e të gjitha dokumenteve për përmbylljen e projektit, përfshirë:
- kopjen e pranimit teknik/pagesat si konfirmim zyrtar për përfundimin e projekteve dhe
- shumën finale të projektit.

10. Komuna obligohet që të njoftojë MAPL-në për çdo propozim ndryshim eventual të sasisë dhe kualitetit gjatë implementimit të projektit.

11. Komuna obligohet të informojë MAPL-në për dinamikën e punimeve deri në përfundim të projektit.

12. Komuna obligohet që pas nënshkrimit të kontratës me operatorin ekonomik dhe para fillimit të realizimit të punimeve në terren, të organizoj ceremoninë inauguruese për realizimin e projektit. Ftesa për pjesëmarrje në këtë ceremoni duhet të dërgohet në MAPL dhe tek Donatorët, së paku 10 ditë para mbajtjes së ceremonisë.

13. Komuna obligohet që para fillimit të realizimit të punimeve në terren të vendosë tabelën informuese (panon) në vend ndërtim, me të gjitha informatat e nevojshme lidhur me projektin duke përshirë edhe tekstin "Emrin e Projektit, vlerë dhe burimin e financimit, në kuadër të skemës së grantit të përformancës".

14. Komuna obligohet që gjatë çdo aktiviteti apo postim promovues lidhur me projektin, të përfshijë "Emrin e Projektit, vlerë dhe burimin e financimit, në kuadër të skemës së grantit të përformancës".;

15. Komuna obligohet që pas përfundimit të punimeve në terren, të organizoj ceremoninë përmbyllëse të projekti. Ftesa për pjesëmarrje në ketë ceremoni duhet të dërgohet në MAPL dhe tek Donatoret së paku 10 ditë para mbajtjes së ceremonisë.

16. Në rast të mos respektimit të rregullave dhe standardeve të cekura në pikat 12, 13, 14 dhe 15 të këtij neni nga Komuna, mund të aplikohet neni 10.2 i kësaj marrëveshje.

17. Projektet janë të qasshme në çdo kohë për auditim të rregullt vjetor që kryhet nga Zyra Kombëtare e Auditimit në Kosovë (ZKAK) dhe për auditimet e kërkuara nga DEMOS-i dhe/ose donatorët e tij për projektet e financuara nga buxheti i DEMOS si pjesë e GPK-së.

## Neni 7
## Dokumentacioni i nevojshëm i komunës për pagesë të projektit të financuar nga buxheti i MAPL

1. Komuna obligohet që për të realizuar pagesat për punët/furnizimet e kryera të kompletojë dokumentacionin si në vijim:

1.1. Kopjen e Kontratës të nënshkruar së bashku me Kushtet e përgjithshme, të veçanta dhe ofertën financiare e cila duhet të jetë identike me origjinalin e vërtetuar nga menaxheri i prokurimit të komunës.

1.2. Vendimin për caktimin e projekt menaxherit/organit mbikëqyrës/komisionin e pranimit nga ana e Komunës, në rast se nuk është e definuar me kushtet e veçanta në kontratë.

1.3. Raportin e projekt menaxherit/organit mbikëqyrës, komisionit të pranimit mbi punët/furnizimet e kryera të aprovuara (origjinali).

1.4. Faturën nga operatori ekonomik dhe situacionin e aprovuar (origjinali).

1.5. Sigurimin e ekzekutimit, garancionin e kualitetit me pranim teknik sipas kushteve të kontratës.

## Neni 8
## Afati i realizimit të projektit

1. Komuna duhet të ndërmerr të gjitha masat që projekti i financuar nga MAPL të përfundojë brenda vitit fiskal 2023.

2. Komuna duhet të ndërmerr të gjitha masat që projekti i financuar nga DEMOS të filloj në vitin 2023 dhe të përfundojë brenda vitit fiskal 2023. Në rast se projekti nuk përfundon gjatë vitit 2023, komuna mund t'i bart mjetet e pashpenzuara të GPK-së në vitin 2024 për vazhdimin e projektit sipas kësaj marrëveshje. Fondet e pashpenzuara sipas nenit 3.3 duhet t'i kthehen DEMOS jo më vonë se 25 dhjetor 2024.

3. Pas përfundimit të afatit të përcaktuar në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni, të gjitha detyrimet i bartë Komuna.

## Neni 9
## Pronësia e projektit

